

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5603
E martë, 16 tetor 2018
çmimi 0.40 €

Shtyhet votimi i rezolutës për dialogun me Serbinë

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

ZGJEDHJET E PARAKOHSHME, ZGJIDHJE APO VAZHDIM I STATUS QUOSË!

F. 10-11



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

SHTYHET DERI MË 31 TETOR AFATI PËR APLIKUESIT PËR LISTËN E BARNAVE ESENCIALE F. 7

MIRATOHET SHPALLJA E KONKURISIT PËR DOKTORATË NË UP F. 3

EKONOMI

OEAK-U: NDËRTIMI I TERMOCENTRALIT 'KOSOVA E RE', I DOMOSDOSHËM F. 9

BUJQIT E KOSOVËS SË SHPEJTI DO TË EKSPORTOJNË NË HUNGARI F. 9

KULTURË

KOLEKSIONISTJA BRITANIKE EKSPONON 37 BOTIME PËR SKËNDERBEUN F. 11

NJË PANORAMË E ASPEKTEVE TË JETËS SHKRIRË NË VARGJE POETIKE F. 13

SPORT

U21-shat DUAN T'I MBYLLIN KUALIFIKIMET ME FITORE F. 18

SOT ZHVILLOHEN DY NDESHJE NË SUPERLIGË F. 18



FLET PËR "EPOKËN E RE", ARMEND ZEMAJ I FAQE 4-5

Zgjedhjet e reja janë interes shtetëror

Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Armend Zemaj, ka vlerësuar se zgjedhjet e reja janë shumë të nevojshme. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka bërë me dije se zgjedhjet e parakohshme nuk janë më vetëm kërkesë e opozitës, por edhe interes shtetëror i Kosovës. Sipas tij, institucionet aktuale kanë humbur legjitimitetin e nevojshëm për ta udhëhequr vendin. Zemaj ka treguar se LDK-ja synon rrëzimin e Qeverisë përmes një koordinimi opozitar, duke llogaritur edhe në mbështetjen e disa deputetëve të koalicionit qeverisës. Ai ka bërë të qartë qëndrimin e LDK-së sa i përket dialogut me Serbinë. "Nuk mund të ketë dialog të mirëfilltë pa stabilitet institucional. Ne si LDK kërkojmë legjitimitet të ri i cili garanton konsensus, njëherësh raport korrekt me partnerët ndërkombëtarë", është shprehur Zemaj

AKR-ja emëron dy ministra të rinj



Fatmir Matoshi dhe Ekrem Mustafa janë dy ministrat e rinj të Qeverisë së Kosovës nga radhët e Aleancës Kosova e Re (AKR). Matoshi është emëruar ministër në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), ndërsa Mustafa

ministër i Punëve të Brendshme (MPB). Presidenti i AKR-së, Behgjet Pacolli, ka bërë me dije se këto ndryshime kanë ndodhur në kuadër të riorganizimit të përgjegjësiave institucionale me propozimin e tij si lider partie



Daci sjell
prapaskenat
dhe sfidat që
karakterizuan
lindjen e shtetit
të Kosovës I FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANK VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Scott: ShBA-ja e konsideron Kosovën shtet

BEOGRAD, 15 TETOR - Ambasadori i ShBA-së në Beograd, Kyle Scott, ka thënë të hënën se Qeveria e Kosovës nuk është e ashtuquajtur, por Qeveri e Kosovës, e cila është një shtet i pavarur dhe sovran, me përfaqësuesit e tyre të zgjedhur.

Scott në këtë mënyrë është përgjigjur në Qeverinë serbe në pyetjen e një gazetari se sa ka shpresë për paqe, kur vazhdimisht është duke u bërë presion mbi Serbinë për bisedime me të ashtuquajturën

Qeverinë e Kosovës, kanë njoftuar mediet serbe. "Nuk është e ashtuquajtura Qeveri e Kosovës, por Qeveri e Kosovës, ne e konsiderojmë Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. Ata janë përfaqësuesit e zgjedhur të Kosovës dhe me ta ne kemi kontakte si me çdo përfaqësues të disa vendeve të rajonit", tha diplomati amerikan.

Scott ka thënë se stabiliteti në rajon ka mund të jetë më i mirë, por se ekziston përparim dhe se një nga faktorët kryesor është

pikërisht zhvillimi ekonomik. "Një nga mënyrat është edhe projekti i korridorit të Moravës për të cilin po flasim sot, i cili do të ndikojë në përmirësimin e jetës së qytetarëve të Serbisë dhe do të sjellë stabilitet ekonomik dhe politik", ka thënë Scott. Ambasadori amerikan ka qenë i pranishëm në Qeverinë e Serbisë në nënshkrimin e memorandumit për bashkëpunim me kompaninë amerikane Bechtel për projektin e ndërtimit të korridorit të Moravës.



Parlamenti maqedonas fillon debatin për ndryshimet kushtetuese

Për t'i bërë ndryshimet kushtetuese nevojitet një shumicë e kualifikuar prej dy të tretash të numrit të deputetëve në Parlamentin maqedonas, që partitë qeveritare nuk e kanë dhe duket se partitë e pushtetit dhe ato opozitare janë ende larg afërimit për sa i përket konsensusit për emrin e ri të vendit

SHKUP, 15 TETOR - Parlamenti i Maqedonisë filloi seancën për ndryshimet kushtetuese, lidhur me ndryshimin e emrit të Republikës së Maqedonisë në "Republika e Maqedonisë së Veriut". Për këtë qëllim nevojitet një shumicë e kualifikuar prej dy të tretash të numrit të deputetëve në parlament, që partitë qeveritare nuk e kanë. Duket se partitë e pushtetit dhe ato opozitare janë ende larg afërimit për sa i përket konsensusit për emrin e ri të vendit.


Partitë e shumicës parlamentare, së bashku me partitë shqiptare të opozitës Aleanca për Shqiptarët dhe njëri krah i Lëvizjes Besa, përbëjnë 71 ligjvënës, ndërkohë që për arritjen e 2/3-ve nevojiten edhe 9 deputetë të opozitës.

Kryeministri Zoran Zaev ofroi një lloj pajtimi në këmbim të votimit të ndryshimeve kushtetuese. "Të falim dhe të pajtohemi", tha ai. Oferta e tij nënkuptohet si amnisti lidhur me ngjarjet e dhunshme të 27 prillit 2017 në parlament, ku

Zaev ishte ndër më të dëmtuarit bashkë me Ziadin Selën e Aleancës për Shqiptarët.

Në komentet e tyre në parlament deputetët opozitarë kritikuan mungesën e bashkëpunimit dhe konsultimeve nga ana e pushtetit para nënshkrimit të marrëveshjes së Prespës me Greqinë fqinje lidhur me ndryshimin e emrit të Maqedonisë.

Mediat në Shkup në orët e mbrëmjes të së hënës kanë njoftuar se debati në seancë plenare për qasje në ndryshimet kushtetuese ka përfunduar për të hënën, për të vazhduar sot (e martë) në orën 11:00. Të hënën e fundit foli Irena Stefanova, deputete e pavarur nga shumica parlamentare. Ajo i kushtoi shumicën e fjalimit së vet deputetëve të VMRO-DPMNE-së. Stefanova theksoi se deputetët nga VMRO-DPMNE në debatin e së hënës nuk ofruan ndonjë alternativë tjetër në rast se Marrëveshja e Prespës dështon. Ndryshe, debati në fazën e parë në seancën plenare në Kuvend mund të zgjasë më së shumti 10 ditë.



Mogherini: Mundësi unike që mund të mos përsëritet

Parlamenti maqedonas ka nisur të hënën debatin rreth amendamenteve kushtetuese të propozuara lidhur me ndryshimin e emrit të Maqedonisë, gjë që do t'i stabilizonte raportet e saj me Greqinë e do t'i hapte vendit rrugën integritet euroatlantik. Ndërsa përfaqësuesja e Politikës së Jashtme të Bashkimit Evropian, Federica Mogherini, ritheksoi mbështetjen e marrëveshjes mes Athinës dhe Shkupit, duke shtuar se kjo ka qenë një mundësi unike për pajtim në Ballkanin

Perëndimor, që mund të mos ndodhë më. "Shpresoj që të gjithë aktorët politikë ta kuptojnë rëndësinë dhe garantojnë një të ardhme të vendit në BE, një të ardhme që i gjithë vendi prej vitesh shpreson se do të bëhet realitet", tha Mogherini. Kjo është një marrëveshje historike, e përshëndetur nga e gjithë Evropa dhe mund të sjellë ndryshime të mëdha në të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor", tha shefja e diplomacisë evropiane, Federica Mogherini.

PE-ja mbështet Shqipërinë, hapja e negociatave në 2019-n

TRANË, 15 TETOR - Grupet parlamentare në Parlamentin Evropian kanë theksuar mbështetjen e plotë për hapjen e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë me BE-në në qershor të 2019-s.

Lajmi bëhet me dije nga bashkëkryetari i delegacionit shqiptar në PE, Taulant Balla, i cili falënderon të gjitha grupet parlamentare për mbështetjen e gjerë. "Faleminderit grupeve

më të mëdha politike nga e djathta në të majtë në PE, për miratimin me unanimitet të Deklaratës Përfundimtare të Komitetit të Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri, e cila fillon me këtë fjalë: Rishprehim mbështetjen e plotë për hapjen e negociatave të anëtarësimit në Bashkimin Evropian në qershor 2019".

Balla thekson se "jam krenar që Shqipëria ka këtë mbështetje



kaq të madhe në PE", ndërsa shpreh keqardhje "për teatrin e radhës së opozitës edhe këtu, ku duhet të jemi të gjithë bashkë për Shqipërinë që duam".

Deklarata përfundimtare, në mbështetje të hapjes së negociatave, u mor të hënën në Bruksel, në përfundim të mbledhjes së Komitetit Parlamentar të Stabilizim-Asociimit, BE - Shqipëri.

Mbahet vazhdimi i seancës së Kuvendit të Kosovës

Shtyhet votimi i rezolutës për dialogun me Serbinë



Deputeti i Partisë Socialdemokrate (PSD), Visar Ymeri, ka kërkuar të hënën në seancën e Kuvendit që të shtyhet votimi i propozimrezolutës për dialogun me Serbinë derisa të ketë përaftrim të qëndrimeve nga grupet parlamentare. Në këtë seancë është debatuar edhe për shtesat e fëmijëve, por rezoluta e iniciuar për këtë çështje nga deputetja e AAK-së, Donika Kadaj-Bujupi, nuk u votua për shkak të mungesës së kuorumit

Parlamentar i AAK-së në lidhje me shtesat e fëmijëve.

Deputetja Kadaj-Bujupi ka thënë se si Kuvend mund të angazhohen bashkë pa dallime partiake sepse kjo, sipas saj, është çështje strategjike me interes kombëtar në mënyrë që shtesat për fëmijë të bëhen realitet jo më larg se në vitin tjetër. Ajo ka thënë se janë dy arsye kryesore pse mendon që kjo duhet të ndodhë. "E para, barazia ndërmjet fëmijëve është parakusht për zhvillimin e tyre. Pra, përfshirja e tyre në arsim, luftimi i varfërisë, i kequshqyerjes, angazhimi për barazi dhe solidaritet ndërmjet fëmijëve është punë në të cilën duhet të investojmë të gjithë ne", ka thënë ajo. Ajo ka shtuar se edhe pse Kosova ka popullsinë nga më të rejtat në Evropë, ka një rënie të natalitetit. Sipas Kadaj-Bujupit, prej vitit 2011 deri në vitin 2017 janë 70 mijë lindje më pak, derisa ka shtuar se faktor për këtë rënie është edhe mungesa e shtesave. "Pra, për më pak se gjashtë vjet kemi 70 mijë lindje më pak. Numri në rënie i lindjeve vjen si

pasojë e disa faktorëve siç është migrimi i popullsisë në vendet e BE-së, shtyrjes së martesave, rritjes së numrit të divorceve dhe mungesës së përfitimeve ose shtesave të fëmijëve të cilat ekzistojnë në çdo vend të BE-së, ndërsa institucionet e Kosovës nuk kanë arritur të dizajnojnë politika të cilat do ta parandalojnë rënien e natalitetit", ka deklaruar Kadaj-Bujupi.

Ajo ka thënë se rezoluta që ka propozuar parasheh që çdo fëmijë në Kosovë prej moshës 0 deri në 16 vjeç të gëzojë shtesa çdo muaj duke filluar nga 10 euro pastaj, sipas mundësive buxhetore, kjo shumë të rritet. Sipas saj, rezoluta kërkon që rekomandimet e saj të zbatohen në buxhetin për vitin e ardhshëm duke u shndërruar në vijë buxhetore.

Deputetja e PDK-së, Flora Brovina, u shpreh se pasi propozimi vjen nga partia e kryeministrit, beson se është diskutuar buxheti dhe të realizohen shtesat për fëmijë, të cilat vlerësoi se janë të domos-

doshme.

Kurse deputetja nga Partia Social Demokrate, Besa Bafiu, ka thënë se si parti e përkrahin iniciativën e deputetes Kadaj-Bujupi për shtesat e fëmijëve, por ka kërkuar që shtesat për fëmijë të jenë deri në moshën 18-vjeçare. Pas debatit në Kuvend për shtesat e fëmijëve, ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka thënë se nataliteti nuk është bërë brengë e këtij vendi në mungesë të buxhetit, por në mungesë të iniciativave dhe në mungesë të ndërmarrjeve.

Reçica ka bërë me dije se janë në fund të draftimit të koncept-dokumentit për reformën e sistemit pensional dhe, sipas tij, në këtë konceptdokument parashihet krijimi i fondit për sigurime sociale, në të cilën në një të ardhme të afërt do të instalohet edhe sistemi i shtesave për fëmijë.

Në fund të këtij debati të iniciuar nga deputetja e AAK-së, Donika Kadaj-Bujupi, nuk është votuar rezoluta e propozuar nga ajo për shkak të mungesës së kuorumit.

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 15 TETOR - Votimi i propozimrezolutës nga debati parlamentar për dialogun me Serbinë është shtyrë për një ditë tjetër pasi, sipas deputetit të PSD-së, Visar Ymerit, ka nevojë edhe për pak kohë për përaftrimin e qëndrimeve mes grupeve parlamentare. "Ka një vonesë shumë të madhe sa i përket rezolutës. Ne jemi të interesuar dhe ftojmë grupet parlamentare për një përaftrim të qëndrimeve për sa i përket rezolutës", ka thënë Ymeri të hënën në vazhdimin e

seancës së Kuvendit të Kosovës. Në këtë seancë, ku u shqyrtuan pikat e mbetura nga seancat paraprake, nuk morën pjesë deputetët e LDK-së dhe ata të Vetëvendosjes.

Deputetët e Kuvendit të Kosovës në këtë seancë kanë votuar tre anëtarët e Bordit të RTK-së. Anëtarë të Bordit të RTK-së për një mandat trevjeçar janë zgjedhur: Agron Gashi, Lirim Geci dhe Sali Bashota. Kuvendi ka vazhduar seancën me debatin parlamentar, sipas kërkesës së deputetes Donika Kadaj-Bujupi, mbështetur edhe nga shtatë deputetët nënshkrues nga Grupi

Miratohet shpallja e konkursit për doktoratë në UP

PRISHTINË, 15 TETOR - Senati i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" në mbledhjen e së hënës ka miratuar shpalljen e konkursit për studimet e doktoratës për vitin akademik 2018/19. Ajo që ngjalli debat më së shumti në mes të anëtarëve të Senatit ishte nëse kandidatët

duhet ta kenë edhe gjuhën angleze në kuadër të provimit pranues. Ushtruesi i detyrës së sekretarit në rektorat, Esat Kelmendi, ka thënë se disa prej njësive akademike kanë paraparë gjuhën angleze në kuadër të provimit pranues. "Në rregullore parashihet të jetë i veçantë. Do të ishte mirë të ishte

unifikues sepse herën e kaluar ka pasur probleme. Prandaj duhet të diskutojmë se a duhet të jetë i ndarë apo jo", ka deklaruar Kelmendi.

Edhe dekani i Fakultetit të Edukimit, Ethem Çeku, ka insistuar që gjuha angleze të jetë pjesë e provimit.



Flet për "Epokën e re", Armend Zemaj

Zgjedhjet e reja janë interes



Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Armend Zemaj, ka vlerësuar se zgjedhjet e reja janë shumë të nevojshme. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka bërë me dije se zgjedhjet e parakohshme nuk janë më vetëm kërkesë e opozitës, por edhe interes shtetëror i Kosovës. Sipas tij, institucionet aktuale kanë humbur legjitimitetin e nevojshëm për ta udhëhequr vendin. Zemaj ka treguar se LDK-ja synon rrëzimin e Qeverisë përmes një koordinimi opozitar, duke llogaritur edhe në mbështetjen e disa deputetëve të koalicionit qeverisës. Ai ka bërë të qartë qëndrimin e LDK-së sa i përket dialogut me Serbinë. "Nuk mund të ketë dialog të mirëfilltë pa stabilitet institucional. Ne si LDK kërkojmë legjitimitet të ri i cili garanton konsensus, njëherësh raport korrekt me partnerët ndërkombëtarë", është shprehur Zemaj.

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 15 TETOR - Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Armend Zemaj, e sheh urgjente mbajtjen e zgjedhjeve të reja. Ai ka bërë me dije se zgjedhjet e parakohshme nuk janë më vetëm kërkesë e opozitës, por edhe interes shtetëror i Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Zemaj ka thënë se këto institucione e kanë humbur legjitimitetin popullor për ta drejtuar vendin. "Tanimë ekziston arsye e plotë se këto institucione kanë humbur edhe atë legjitimitet të paktë që e kanë pasur. Dhe nevoja për të shkuar në zgjedhje të reja nuk është vetëm kërkesë e jona, por edhe

interes shtetëror", ka thënë Zemaj. Ai ka treguar se pikërisht për shkak të mungesës së legjitimitetit të këtyre institucioneve, LDK-ja nuk do të bëhet pjesë e procesit të dialogut me Serbinë. Sipas tij, vetëm pas zgjedhjeve të reja mund të flitet për fazën finale të dialogut Kosovë - Serbi. "Nuk mund të ketë dialog të mirëfilltë pa stabilitet institucional. Ne si LDK kërkojmë legjitimitet të ri i cili garanton konsensus, njëherësh raport korrekt me partnerët ndërkombëtarë, të cilët e kanë mbështetur Kosovën në rrugën e saj për liri dhe pavarësi. Ne së pari kërkojmë të kemi konfirmim të mbështetjes popullore dhe të marrim diçka e cila nuk krijon besim ashtu siç po pretendon Qeveria aktuale me disa lloj të grupeve, individë dhe ikje nga

përgjegjësia ligjore që kanë", është shprehur Zemaj.

Deputeti i LDK-së ka folur edhe për rrugën që do ta ndjekë opozita për ta rrëzuar Qeverinë Haradinaj. Zemaj ka bërë me dije se për këtë qëllim opozita synon ta ketë edhe përkrahjen e disa deputetëve të pozitës. "Vetëm me forma demokratike, të koordinuar dhe me grupet e tjera opozitare dhe duke zgjeruar angazhimin që të bindim edhe deputetë të tjerë të cilët do të dalin nga interesi i ngushtë politik dhe ta krijojnë mundësinë e përqafimit të një vendimi i cili mendojmë se është në interes të përgjithshëm të Kosovës", ka deklaruar Zemaj.

"Epoka e re": Z. Zemaj, LDK-ja nuk ka marrë pjesë në seancën e së hënës. Pse?

Zemaj: E kemi deklaruar edhe

shtetëror

shkuar në zgjedhje të reja nuk është vetëm kërkesë e jona, por edhe interes shtetëror.

"Epoka e re": Keni paralajmëruar se do të merrni pjesë vetëm në seancën që do të votohet transformimi i FSK-së. A do të thotë kjo se LDK-ja ka zgjedhur bojkotonin e Kuvendit dhe tash e tutje do ta braktisë çdo seancë?

Zemaj: Veprimi ynë është politik dhe në interes të përgjithshëm të qytetarëve të Kosovës. LDK-ja ka treguar seriozitet në votimin e ligjeve të cilat integrojnë vendin në strukturat evropiane, për liberalizimin e vizave dhe njëherësh çdo ligj që plotëson kornizën kushtetuese e institucionale të Republikës së Kosovës ku transformimi i FSK-së në ushtri të Kosovës është pjesë programore e jona dhe objektiv strategjik në forcimin e stabilitetit nacional dhe rajonal të vendit tonë. Për seancat e tjera dhe pikat e tjera në çdo rend do të vendosim në koordinim me subjektin, njëherësh edhe me spektrin tjetër opozitar si bashkim kundër kësaj qeverie të keqe.

"Epoka e re": LDK-ja së fundi ka bërë me dije se në asnjë mënyrë nuk do të bëhet pjesë e dialogut me Serbinë. Pse ky subjekt politik nuk po merr përgjegjësinë që i takon në këtë proces?

Zemaj: Nuk mund të ketë dialog të mirëfilltë pa stabilitet institucional. Ne si LDK kërkojmë legjitimitet të ri i cili garanton konsensus, njëherësh raport korrekt me partnerët ndërkombëtarë, të cilët e kanë mbështetur Kosovën në rrugën e saj për liri dhe pavarësi. Ne së pari kërkojmë të kemi konfirmim të mbështetjes popullore dhe të marrim diçka e cila nuk krijon besim ashtu siç po pretendon Qeveria aktuale me disa lloj grupe, individë dhe ikje nga përgjegjësia ligjore që kanë.

"Epoka e re": Vazhdimisht po pretendoni se do ta rrëzoni Qeverinë dhe do ta çoni vendin në zgjedhje të reja. Si do ta bëni këtë? Pozita thotë se nuk i keni numrat.

Zemaj: Vetëm me forma demokratike, të koordinuar edhe me grupet e tjera opozitare dhe duke zgjeruar angazhimin që t'i bindim edhe deputetët e tjerë të cilët do të dalin nga interesi i ngushtë politik dhe të krijojnë mundësinë e përqafimit të një vendimi i cili mendojmë se është në interes të përgjithshëm të Kosovës.

AKR-ja emëron dy ministra të rinj

Fatmir Matoshi dhe Ekrem Mustafa janë dy ministrat e rinj të Qeverisë së Kosovës nga radhët e Aleancës Kosova e Re (AKR). Matoshi është emëruar ministër në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), ndërsa Mustafa ministër i Punëve të Brendshme (MPB). Presidenti i AKR-së, Behgjet Pacolli, ka bërë me dije se këto ndryshime kanë ndodhur në kuadër të riorganizimit të përgjegjësive institucionale me propozimin e tij si lider partie

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 15 TETOR - Ekrem Mustafa do të jetë ministër i ri i Punëve të Brendshme pas lirim të këtij posti nga Bejtush Gashi, ndërkaq Fatmir Matoshi do të jetë ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Presidenti i Aleancës Kosova e Re (AKR), Behgjet Pacolli, ka folur pas emërimit të dy ministrave të rinj në Qeveri. Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se në kuadër të riorganizimit të përgjegjësive institucionale, me propozimin e tij si lider partie i ka propozuar kryeministrit Ramush Haradinaj kërkesën për ta emëruar Fatmir Matoshin, ministër të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ekrem Mustafën, ministër të Punëve të Brendshme. Pacolli ka thënë se Bejtush Gashi do të marrë një përgjegjësi të rëndësishme institucionale. "Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës, në kuadër të riorganizimit të përgjegjësive institucionale, sot, me propozimin tim si president i AKR-së, i kam adresuar

kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, një kërkesë për ta emëruar Fatmir Matoshin ministër të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ekrem Mustafën, ministër të Punëve të Brendshme. Dua të falënderoj për kontributin e tij të deritashëm Bejtush Gashin, i cili në ditët në vijim do të marrë një përgjegjësi të rëndësishme institucionale, në funksion të realizimit të objektivave tona qeverisëse", ka shkruar Pacolli. Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e AKR-së, Labinot Tahiri, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se Ekrem Mustafa u emërua ministër i Punëve të Brendshme pas kërkesës së tij në AKR dhe Qeverinë e Kosovës. "Ferizaj si tatimpagues kryesor dhe disa herë edhe përcaktues i fitoreve në qendër të partive politike nuk kishte ministër. Tani, 19 vjet pas, me kërkesën time si deputet, drejtuar Qeverisë së kryesuar nga kryeministri Ramush Haradinaj dhe partnerët e koalicionit, u vendos që Ferizaj të bëhet me ministër", ka shkruar deputeti Tahiri.

Drejtori ekzekutiv i KIPRED-it,

Lulzim Peci, ka reaguar pas shkarkimit të ministrit të Punëve të Brendshme, Bejtush Gashit, dhe zëvendësimit të tij nga Ekrem Mustafa. Në një postim në profilin e vet në "Facebook", Peci ka shprehur habinë rreth shkarkimit të ministrit të Brendshëm në kohën kur, sipas tij, krejt forcat duhet të mobilizohen për anëtarësimin e Kosovës në Interpol. Ish-ambasadori Lulzim Peci ka ngritur dyshime se mos Qeverisë nuk po i ecën puna mirë në përpjekjen për anëtarësim në Interpol dhe po i duhet një "kurban" për ta arsyetuar dështimin e mundshëm. Sipas Pecit, akti i shkarkimit të ministrit Gashi ka vetëm një emër: "Mungesë totale e sensit të qeverisjes. Po ku e gjetet për ta shkarkuar ministrin e Brendshëm në kohën kur krejt forcat duhet të mobilizohen për anëtarësimin e Kosovës në Interpol? Apo, ndoshta, nuk po ju ecën puna mirë në këtë përpjekje dhe po ju duhet një 'kurban' për ta arsyetuar dështimin e mundshëm? Ky akt e ka vetëm një emër: Mungesë totale e sensit të qeverisjes", ka shkruar Peci.



në Kryesi të Kuvendit, se nuk do të marrim pjesë në vazhdimin e kësaj seance. Për këtë kemi treguar edhe arsyet. E para është bllokimi i rezolutës së opozitës e cila e kishte në theks të veçantë mbrojtjen e integritetit territorial të Kosovës. Kjo rezolutë njëherësh do të krijonte një mundësi për ridizajnim të dialogut, i cili do të ishte i strukturuar dhe në interes të fuqizimit të subjektivitetit të brendshëm të vendit. Sipas kësaj rezolute, Kosova në plotësi do të dialogonte si shtet unitar dhe jo në shërbim të interesave të pozitës apo të individëve të veshur me pozita udhëheqëse në Kosovë. Ndërsa tanimë ekziston arsye e plotë se këto institucione kanë humbur edhe atë legjitimitet të paktë që e kanë pasur. Dhe nevoja për të

Instituti EPIK: 6-7 dhjetori, dita D për liberalizimin e vizave

PRISHTINË, 15 TETOR (ER) - Instituti EPIK nëpërmjet një komunikate për medie ka vlerësuar se Kosova është duke hyrë në pjesën më të rëndësishme të vendimarrjes që zhvillohet në kuadër të institucioneve të BE-së lidhur me procesin e liberalizimit të vizave. Mbledhja e Këshillit të BE-së, e fundit për këtë vit, në përbërje të ministrave të brendshëm dhe të drejtësisë, është më 6-7 dhjetor,

është kritik për ta jetësuar lëvizjen e lirë të qytetarëve tanë. Sipas këtij instituti, lufta e vërtetë diplomatike duhet të koncentrohet te vendet kryesore të BE-së të cilat kanë hezitime për të votuar pro liberalizimit të vizave, e që në bazë të votimit në Parlamentin Evropian, kemi parë se bëhet fjalë për Holandën, Francën dhe Gjermaninë. "Andaj sa i përket datës së saktë të lëvizjes së lirë,

Instituti EPIK i fton të gjithë përfaqësuesit institucionalë që të jenë të përbajtur rreth afateve për liberalizimin e vizave dhe të mos rrisin pritshmëri joreale tek qytetarët për një çështje kaq të ndjeshme për ta. Në veçanti duhet nënvizuar se, bazuar në dinamikën e liberalizimit të vizave të dy vendeve të fundit që kanë përfituar nga ky proces, Gjeorgjia dhe Ukraina, sot mund konfir-

mohet me siguri që lëvizja e lirë për Kosovën është e pamundur të bëhet deri në fund të këtij viti", është theksuar në komunikatën e EPIK-ut. Instituti EPIK konsideron se skenari më pozitiv i mundshëm është që vendimarrja për procesin e liberalizimit të vizave të përfundojë këtë vit, ndërsa qytetarët të lëvizin lirshëm në vitin 2019.



UNDP-ja dhe Ambasada e Gjermanisë mbështesin sektorin e sigurisë në Kosovë

EPOKA E FATON DËRMAKU

PRISHTINË, 15 TETOR - Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe Ambasada e Gjermanisë në Prishtinë kanë nënshkruar marrëveshje për t'i mbështetur institucionet e Kosovës për kontrollimin e posedimit të gjerë dhe qarkullimin e armëve të vogla dhe të lehta (AVL) dhe për ta përmirësuar hetimin e krimeve të kryera me armë.

Vlera e përgjithshme e marrëveshjes së nënshkruar kap shumën 130 mijë euro.

Iniciativa e re, e cila do të jetë pjesë e Projektit të Sigurisë së Kosovës (KSSP), do t'i ndihmojë institucionet e Kosovës për reduktimin e armëve të paligjshme, fuqizimin e kornizës ligjore në përputhje me direktivat e fundit të BE-së dhe rritjen e aftësive për t'i hetuar krimet e kryera me armë. "Përmes këtij projekti mbështetja do të sigurohet për: harmonizimin e kornizës ligjore për armët bazuar në direktivat e BE-së; implementimin e ligjit të Kosovës për legalizimin dhe dorëzimin vullnetar të armëve, municioneve dhe mjeteve shpërthyes; dhe përditësimin e regjistrimit të

armëve, licencimit, importit dhe bazës së të dhënave për eksportin", është thënë në komunikatën për medie të UNDP-së.

Me këtë rast ambasadori gjerman Christian Heldt ka konfirmuar angazhimin e vazhdueshëm të vendit të tij që nga viti 2014 për mbështetjen e iniciativave të AVL-ve në sektorin e sigurisë në Kosovë. "Ne jemi krenar që vazhdojmë këtë projekt jashtëzakonisht të rëndësishëm me UNDP-në, i cili synon t'i mbështesë institucionet e Kosovës për reduktimin e sasisë së armëve të vogla dhe të lehta në vend dhe në këtë mënyrë të ndikojë në ngritjen e përgjithshme të sigurisë për qytetarët e Kosovës", është shprehur Heldt.

Republika Federale e Gjermanisë dhe Ambasada në Prishtinë janë avokatë të fuqishëm për rritjen e nivelit të sigurisë publike në Kosovë dhe për të arritur këtë qëllim vazhdojnë të punojnë me Zyrën e UNDP-së në Kosovë edhe për ofrimin e mbështetjes teknike dhe ekspertizës.

Koordinatorja e OKB-së për Zhvillim, njëkohësisht Përfaqësuesja e Përhershme e UNDP-së, Ulrika Richardson, ka shprehur vlerësimin e saj



ndaj Republikës Federale të Gjermanisë për besimin dhe angazhimin e tyre ndaj UNDP-së për mbështetjen e kontrollit të armëve të vogla dhe të lehta (AVL-ve). "Puna për adresimin e kontrollit të armëve të vogla dhe të lehta (AVL) është pjesë e

angazhimit të UNDP-së për ta promovuar sigurinë njerëzore dhe zhvillimin e qëndrueshëm në Kosovë dhe për t'i përbushur përgjegjësitë ndërkombëtare si dhe për të kontribuar në sigurinë rajonale dhe ndërkombëtare, në veçanti

duke implementuar udhërrëfyesin për një zgjidhje të qëndrueshme ndaj posedimit të paligjshëm, keqpërdorimit dhe trafikimit të AVL-ve në Ballkanin Perëndimor deri në vitin 2024", ka theksuar Richardson.

Filloi trajnimi i gjeneratës së re të Inspektoratit Policor të Kosovës

PRISHTINË, 15 TETOR (ER) - Në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike ka filluar të hënën trajnimi i gjeneratës së re të programit profesional "Inspektor i Inspektoratit Policor të Kosovës", ku pjesëmarrës janë shtatëmbëdhjetë kadetë. Në këtë ceremoni të pranishëm ishin drejtori i përgjithshëm i Akademisë, Ismail Smakiqi, kryeshefja ekzekutive e Inspektoratit Policor të Kosovës, Miradije Kelmendi, si dhe zyrtarë të lartë nga institucionet e sigurisë publike dhe organizatat ndërkombëtare.

Drejtori i Përgjithshëm i Akademisë së Kosovës për Siguri

Publike, Ismail Smakiqi, ka thënë se kjo është gjenerata e parë që po fillon trajnimin bazik të një programi profesional i cili është si rezultat i projektit të binjakëzimit të Komisionit Evropian. Ai ka thënë se është hera e parë që në Akademi një agjenci fillon trajnimin profesional me program të validum nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve si rezultat i punës së përbashkët të ekspertëve vendorë e të projektit të binjakëzimit.

Smakiqi u ka uruar suksese pjesëmarrësve në përfundimin e këtij trajnimi.

Ndërsa kryeshefja e Inspektoratit

Policor të Kosovës, Miradije Kelmendi, ka thënë se sot po shënohet një moment i veçantë pasi është gjenerata e parë që do të trajnohet dhe certifikohet në programe tashmë të njohura dhe të validuara nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve për pozitën profesionale, Inspektor Policor. "Juve ju pret një periudhë e vështirë në të cilën kërkohet angazhim dhe përkushtim i përditshëm. Ne presim që ju ta përfundoni këtë sfidë me rezultate të larta, pastaj bashkë të punojmë si pjesë e strukturës së Inspektoratit Policor për ta rritur efikasitetin dhe profesionalizimin për arritjen me sukses të



misionit të rëndësishëm të përcaktuar me ligj", ka thënë Kelmendi. Ajo ka falënderuar Akademinë e Kosovës për Siguri

Publike dhe stafin për punën dhe përkushtimin e vazhdueshëm duke iu uruar suksese për arritjen e objektivave.

Është promovuar libri "Lindja e vështirë e shtetësisë së Kosovës" i autorit Nexhat Daci

Daci sjell prapaskenat edhe sfidat që karakterizuan lindjen e shtetit të Kosovës

Kryetari i Akademisë së Shkencës dhe Arteve të Kosovës (AShAK), akademik Nexhat Daci, të hënën ka promovuar librin "Lindja e vështirë e shtetësisë së Kosovës" përmes të cilit ka paraqitur prapaskenat dhe zhvillimet që e kanë karakterizuar lindjen e shtetit të Kosovës. Në ceremoninë e promovimit të librit kanë marrë pjesë presidenti Hashim Thaçi, kryeministri Ramush Haradinaj si dhe zëvendëskryeministri Behgjet Pacolli, të cilët kanë vlerësuar se kontributi i Dacit gjatë këtyre viteve ka qenë i rëndësishëm për vendin



në këtë libër pasqyrore saktësisht realitetin e sfidave të shtetndërtimit në Kosovë. "Sot pata kënaqësinë të marr pjesë në promovimin e librit 'Lindja e vështirë e shtetësisë së Kosovës' të akademik Nexhat Dacit. Daci është një nga figurat politike që ka dhënë dhe vazhdon të japë kontribut të jashtëzakonshëm në shtetndërtimin e Kosovës. Libri i tij pasqyron saktësisht realitetin e sfidave të shtetndërtimit në Kosovë, me ilustrim praktik dhe real. Unë kam pasur fatin të jam pjesëmarrës edhe i një pjesë të këtyre ngjarjeve historike. I dëshiroj z. Daci të mos ndalet deri te përfundimi i realizimit të sfidës sonë kryesor: rrumbullakimit të shtetndërtimit", ka thënë Pacolli. Për rëndësinë e librit "Lindja e vështirë e shtetësisë së Kosovës" ka folur edhe akademik Arsim Bajrami. Ai ka thënë se ky libër ofron dëshmi për ta kuptuar situatën, sfidat dhe zhvillimet që kanë karakterizuar punën e institucioneve në kohën e shtetndërtimit. "Ky libër na ofron dëshmi për ta kuptuar situatën nga viti 2001, kur u nxor Korniza Kushtuese për vetëqeverisje dhe pengesat e lajthitjet që i ka sjellë misioni i UNMIK-ut për shtetin e Kosovës. Edhe titulli i librit është adekuat sepse periudha para shpalljes së pavarësisë ka qenë shumë e vështirë. Libri ka një rëndësi të madhe veçmas për generatat e reja", ka thënë Bajrami.

sishëm dhe libri është një retrospektivë e Kosovës, para dhe pas pavarësisë", ka deklaruar Thaçi. Ndërkohë kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se ky libër do t'u shërbejë brezave si pikënisje për ta kuptuar më hollësisht historinë e re të Kosovës. "Zëri i intelektualëve gjithnjë ka qenë udhëzuesi më i mirë i rrugëtimit tonë përplot sfida deri në liri dhe shtetndërtim. Pata nderin të isha i pranishëm në promovimin e librit 'Lindja e vështirë e shtetë-

sisë së Kosovës' të akademikut dhe politikanit të shquar Nexhat Daci. Vrojtimi i akademik Dacit, si një politikan largpamës, për shtetkrijimin tonë, do t'u shërbejë brezave si pikënisje për ta kuptuar më hollësisht historinë e re të Kosovës", është shprehur Haradinaj. Edhe zëvendëskryeministri dhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, ka lavdëruar librin "Lindja e vështirë e shtetësisë së Kosovës", duke thënë se Daci

Ndërsa akademikja Gjyljeta Mushkolaj ka vlerësuar se ky libër plotëson një boshllëk për zhvillimet që kanë karakterizuar periudhën e lindjes së shtetit të Kosovës për t'i parë dhe njohur më mirë sjelljet e politikës së atëhershme të misioneve ndërkombëtare, sidomos të UNMIK-ut. "Libri është i rëndësishëm për ta kuptuar periudhën dhe zhvillimet që karakterizuan shtetndërtimin e Kosovës", ka thënë Mushkolaj.

EPOKA
ERE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 15 TETOR - Ngjarjet që e kanë karakterizuar lindjen e shtetit të Kosovës, prapaskenat dhe sfida me të cilat është ballafaquar politika me misionet ndërkombëtare, janë përmbledhur në librin "Lindja e vështirë e shtetësisë së Kosovës" të autorit akademik Nexhat Daci. Ky libër është promovuar të hënën në Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, në prani të liderëve shtetërorë, presidentit Hashim Thaçi dhe kryeministrit Ramush Haradinaj. Autori i librit dhe kryetari i Akademisë së Shkencës dhe Arteve të Kosovës (AShAK), Nexhat Daci, ka bërë me dije se në librin "Lindja e vështirë e shtetësisë së Kosovës" ka përmbledhur përvojën e tij, sidomos atë sa ka qenë kryetar i Kuvendit të Kosovës. "Krejt këto sjellje më kanë detyruar ta shkruaj rrjedhën e ngjarjeve për të parë që edhe sot shumë pjesë të politikës ndërkombëtare nuk janë të ndershme ndaj popullit dhe klasës politike të Kosovës. Asnjë mision ndërkombëtar i Kombeve të Bashkuara nuk e ka fituar titullin mision pesë jesh", ka deklaruar Daci, duke shtuar se në kohën kur ka drejtuar Kuvendin, klasa politike ka qenë shumë më intelektuale sesa kjo e sotmja. Në

këtë kontekst, ai ka kritikuar opozitën aktuale duke thënë se duhet të punojë për shtetin, dhe jo të mendojë në çdo kohë për rrëzimin e pushtetit.

Daci ka bërë thirrje që të përkrahin institucionet e shtetit dhe të mos bojkotohen proceset nëpër të cilat po kalon Kosova. "Akademia e ka vetëm një kërkesë, që burrështetësit e Kosovës t'i kthehen punës, të shkojnë në seancat parlamentare. Rrinë në holle ose kafeteri duke thënë që unë nuk ia bëj kuorumin këtij ose atij. Është koha për realizimin e shtetësisë së plotë të Kosovës, e jo se kur po i mbajmë zgjedhjet dhe kur po e rrëzojmë presidentin e Qeverinë. Si është e mundur në një vend që nuk ka lëvizje të lirisë krejt koha të shpenzohet për këtë", është shprehur Daci. Kurse praninë e presidentit Thaçi dhe kryeministrit Haradinaj e ka quajtur nder të veçantë për ASHAK-un. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se "Lindja e vështirë e shtetësisë së Kosovës" është libër i veçantë për dekadën e parë të shtetit tonë. "Një libër i veçantë ky për dekadën e parë të shtetit tonë, ku akademik Daci përshkruan hapat e parë të ndërtimit të demokracisë dhe vështirësitë e krijimit të institucioneve vendore. Kontributi i akademik Dacit gjatë gjithë këtyre viteve ishte shumë i rëndë-

Shtyhet deri më 31 tetor afati për aplikuesit për listën e barnave esenciale

PRISHTINË, 15 TETOR (ER) - Në punëtorinë treditore të mbajtur në Prishtinë nga Komiteti Teknik për revidimin e Listës së Barnave Esenciale, me asistencën edhe të ekspertëve të OBSH-së, Komiteti Teknik, duke marrë parasysh kërkesën e subjekteve të ndryshme farmaceutike, vendosi që afati për aplikimet për përfshirjen e bar-

nave të reja dhe ndryshimet ose fshirjen e barnave aktualisht të listuara, në modelin e listës të 2018-s të shtyhet deri më 31 tetor. Periudha e aplikimit është shtyrë për dy javë për ta lehtësuar bashkëveprimin ndërmjet aplikantëve dhe Sekretarisë së Komitetit Teknik për revidimin e LBE-së, për të siguruar që

aplikacionet adresojnë në mënyrë adekuate elementet kritike për përzgjedhjen: rëndësinë e shëndetit publik, efikasitetin klinik dhe sigurinë e barit të propozuar. Çdo aplikim duhet të shoqërohet me një formular të kompletuar të përmbledhjes së informacionit të aplikacionit, të publikuar në uebfaqen e MSH-së.



Nuk kalon Projektligji për Kompleksin Memorial "Adem Jashari"

PRISHTINË, 15 TETOR (ER) - Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Muharrem Nitaj, ka thënë të hënën se është për keqardhje që në seancën e Kuvendit nuk ka arritur të aprovet Projektligji për Kompleksin Memorial "Adem Jashari". Sipas tij, moskalimi i këtij projektligji ka

ardhur për shkak të mungesës së deputetëve të LDK-së dhe Vetëvendosjes. "Është për keqardhje që as sot nuk arriti të kalojë Projektligji për Kompleksin Memorial 'Adem Jashari'! Mungonin deputetët e LDK-së dhe VV-së! Natyrisht votimin e Listës Serbe as që e kemi pritur", ka shkruar Nitaj në llogarinë e vet në "Facebook".



Bahtiri u kërkon drejtorëve dorëzimin e raporteve në afat rekord



MITROVICË, 15 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, në mbledhjen e bordit të drejtorëve, ka kërkuar të hënën nga drejtorët e drejtorive komunale të angazhohen maksimalisht për realizimin e detyrave që parashtrihen para tyre dhe për ofrimin e shërbimeve sa më cilësore ndaj qytetarëve të komunës që i kërkojnë ato. Në këtë takim kryetari Bahtiri ka kërkuar nga drejtorët që me kohë t'i dorëzojnë në drejtorinë e Financave faturat për pagesë dhe që deri në fund të tetorit të

përgatitet raporti për shumën e borxheve totale që ka komuna ndaj institucioneve dhe operatorëve. Po ashtu, Bahtiri ka kërkuar nga drejtorët që menjëherë t'i kompletojnë dokumentet për përfundimin e procesit lidhur me Rregulloren 01/2012 për taksat, gjobat dhe tarifatat komunale. Përveç kësaj, në takim u fol edhe për aktivitetet dhe masat që duhet të ndërmerren ndaj pronarëve të kioskave të vendosura dhe që punojnë pa leje të organeve kompetente.



Përrurohet vendosja e shenjave me emra të rrugëve në Klinë

KLINË, 15 TETOR (ER) - Në Komunën e Klinës është përruar të hënën projekti për vendosjen e shenjave me emra të rrugëve për të gjitha rrugët në këtë komunë. Në këtë aktivitet u bë me dije se mungesa e adresave të unifikuara dhe e shenjave me emra rrugësh ka qenë një sfidë për këtë komunë.

Ky projekt është mundësuar nga donacioni i Autoritetit Norvegjez për Kadastër dhe Hartografi "Kartverket", implementuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit

Hapësinor, respektivisht nga Agjencia Kadastrale e Kosovës. Po ashtu, në një takim mes kryeshëfit ekzekutiv të Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK), Avni Ahmeti, dhe kryetarit të Komunës së Klinës, Zenun Elezaj, u theksua se bashkëpunimi mes këtyre dy institucioneve nuk do të përfundojë me kaq, duke potencuar që për vitin e ardhshëm do të shqyrtojnë të gjitha mundësitë për vendosjen e numrave të adresave për secilën shtëpi, në secilën shtëpi.



Mbi 150 thasë mbeturina largohen nga 'Mati 1' në Prishtinë

PRISHTINË, 15 TETOR (ER) - Dhjetëra vullnetarë të "Let's Do It Kosova" kanë larguar mbi 150 thasë me mbeturina në aksionin e radhës të pastrimit që është mbajtur të hënën në lagjen "Mati 1" në Prishtinë, në kuadër të fushatës më të madhe në vend "Ta pastrojmë Kosovën". Këtij aksioni për pastrimin e kësaj deponie ilegale të mbeturinave në rrugën "Muharrem Fejza" iu bashkuan edhe punëtorët e Kompanisë "PR Solutions", ndërsa thasët me mbetu-

rina u larguan nga Kompania "Pastrimi". Drejtori ekzekutiv i "Let's Do It Kosova", Luan Hasanaj, ka thënë se duhet të ngrihet vetëdija e qytetarëve për rëndësinë e mirëmbajtjes së hapësirave ku ata jetojnë. Ai i ka bërë thirrje Komunës së Prishtinës dhe ndërmarrjeve të pastrimit që t'i rrisin kapacitetet dhe numrin e kontejnerëve në zona të banuara, në mënyrë që të mos krijohen deponi të tilla të mbeturinave në kryeqytet.

Bujqit e Kosovës së shpejti do të eksportojnë në Hungari

PRISHTINË, 15 TETOR (ER) - Ambasadori i Hungarisë në Kosovë, Laszlo Markusz, ka shprehur gatishmërinë për ta mbështetur Kosovën në fushën e bujqësisë në mënyrë që bujqit e Kosovës të eksportojnë në Hungari. Kështu është thënë të hënën gjatë takimit të këtij të fundit me ministrin e Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala. Ministri Shala dhe ambasadori Markusz kanë diskutuar për thellimin e bashkëpunimit në

mes të dy shteteve. "Me emërimin tim në MTI planifikoj ta rris dinamikën e punës dhe prioriteti im është mbrojtja e konsumatorit, që është në përgjegjësinë e ministrisë që drejtoj, mbrojtja e prodhimit vendor dhe stimulimi i prodhuesve vendorë", ka thënë ministri Shala. Ambasadori Markusz ka shprehur gatishmërinë për ta mbështetur Kosovën në fushën e bujqësisë, konkretisht ka ofruar

bashkëpunim që t'u mundësohet bujqve t'i eksportojnë produktet e Kosovës në Hungari dhe u pajtuan ta nënshkruajnë një marrëveshje dyshetërore që do t'i shërbejë Kosovës në fushën e mbrojtjes së investimeve të huaja. Po ashtu, gjatë këtij takimi ambasadori ka paraqitur para ministrit interesimin e një investitori hungarez, i cili do të hapë në Kosovë një fabrikë për prodhimin e makinerisë bujqësore.



OEAK-u: Ndërtimi i termocentralit 'Kosova e Re', i domosdoshëm



Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK) ka vlerësuar se ndërtimi i termocentralit "Kosova e Re" është i domosdoshëm. OEAK-u ka shprehur besimin se një pjesë e konsiderueshme e sfidave me të cilat bizneset janë përballur në fushën e energjisë do ta gjente adresën e zgjidhjes përmes ndërtimit të termocentralit "Kosova e Re"

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 15 TETOR - Oda Ekonomike Amerikane e Kosovës (OEAK) ka reaguar në lidhje me ndërtimin e termocentralit "Kosova e Re", duke vlerësuar se ndërtimi i këtij termocentrali është i domosdoshëm. "Bizneset

në Kosovë, e në veçanti sektori i prodhimit, kanë identifikuar energjinë elektrike si një pengesë të konsiderueshme në zhvillimin e tyre që nga periudha e pas luftës. Furnizimi jostabil me energji elektrike përgjatë viteve i ka shkaktuar dëme shumëmilionëshe industrisë vendore si dhe ka penguar fuqizimin e sektorit të

prodhimit në vend. Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë shpreh besimin se një pjesë e konsiderueshme e sfidave me të cilat bizneset janë përballur në fushën e energjisë do ta gjente adresën e zgjidhjes përmes ndërtimit të termocentralit "Kosova e Re", është theksuar në komunikatën e Odës

Ekonomike Amerikane të Kosovës.

Sipas kësaj ode, krahas zhvillimeve pozitive në vitet e fundit në aspekt të rritjes së stabilitetit dhe parashikueshmërisë së furnizimit, Kosova vazhdon të përballlet me nevojën imediate për krijimin e kapaciteteve të reja gjeneruese të energjisë elektrike.

"Ndërtimi i termocentralit të ri do t'i mundësonte Kosovës t'i zgjeronte kapacitetet gjeneruese dhe rrjedhimisht ta ulte varësinë nga importi i energjisë elektrike. Termocentralet ekzistuese operojnë me teknologji shumë të vjetër, ndërsa një defekt më serioz i tyre do ta përballte Kosovën me krizë energjetike, si dhe do ta rriste varësinë ndaj importit, duke nxitur rrjedhimisht edhe rritjen e çmimit të energjisë", është thënë në komunikatën e Odës Ekonomike Amerikane të Kosovës. "Po ashtu, vlen të theksohet se linjiti paraqet burimin kryesor natyror për Republikën e Kosovës dhe, si i tillë, i njëjti duhet të gjejë shfrytëzim për nxitjen e zhvillimit ekonomik në vend, marrë parasysh edhe teknologjinë e re në këtë fushë, që ka mundësi të ulët dukshëm ndikimi në mjedisin e burimeve të tilla. Normalisht, ndërtimi i termocentralit nuk duhet t'i dekurajojë investimet në zhvillimin e kapaciteteve gjeneruese nga burimet e ripërtërishme të energjisë. Marrë parasysh këto, Oda Amerikane shpreson të shohë në muajt në vijim përmbylljen e suksesshme të përpjekjeve shumëvjeçare të Qeverisë si dhe kompanisë së përzgjedhur, të cilat do të çonin në jetësimin e projektit të termocentralit të ri, si një domosdoshmëri për sektorin privat në vend", është theksuar më tej në këtë komunikatë të Odës Ekonomike Amerikane të Kosovës.

Menaxhmenti i lartë i ATK-së diskuton planet për të ardhmen

PRISHTINË, 15 TETOR - Menaxhmenti i lartë i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) nga data 10 deri më 12 tetor ka mbajtur punëtori lidhur me diskutimin e të arriturave të deritanishme si dhe për sfidat të cilat e presin administratën tatimore në të ardhmen. Gjatë kësaj punëtorie u prezantuan rekomandimet nga

raportet e institucioneve ndërkombëtare të cilat monitorojnë punën e ATK-së, e të cilat pritet të reflektojnë në hartimin e planeve strategjike dhe operative të ATK-së për periudhën e ardhshme. Po ashtu, në punëtori u prezantuan ide, propozime për hartimin e planit strategjik, strategjinë e përbushjes dhe planit operativ, si dhe u caktuan

grupet punuese të cilat do të merren me hartimin e drafteve finale të këtyre planeve. Drejtori i ATK-së, Sakip Imeri, ka kërkuar nga të gjithë pjesëmarrësit e kësaj punëtorie që, sipas përgjegjësisë, t'i marrin veprimet ligjore, në mënyrë që t'i përfundojnë me sukses detyrat e përcaktuara duke respektuar afatet kohore.



ZGJEDHJET E PARAKOHSHME, ZGJIDHJE APO VAZHDIM I STATUS QUOSË!



**Behxhet Sh. SHALA -
BAJGORA**

Si fort po e kruajnë b...n e arushës: Pas zgjedhjeve të fundit parlamentare në Kosovë u formua një qeveri e pakicës shqiptare, por me numra të nevojshëm që të formohej qeveria e që opozita e sulmoi, që nga sekonda e parë e qeverisjes, kryesisht në baza politike dhe patriotike. Menjëherë doli me kërkesë që duhet të shkohet në zgjedhje të reja për të siguruar një qeverisje transparente dhe të mirë, ndonëse LDK-ja ishte pikërisht partia që e kishte timonin qeverisës në mandatin e kaluar. Qeveria që udhëhiqej nga Isa Mustafa mori në thua gjatë mocionit të mosbesimit dhe ky mocion, përveç opozitës, kishte mbështetje të fuqishme edhe te pakicat joserbe që udhëhiqeshin nga Winston Çerçili kosovar, Danush Ademi sikur edhe nga Lista Serbe me të cilët koalicioni paraparak kishte lidhur kumbari dhe duheshin shumë. Edhe puçistët kujdestarë në radhët e PDK-së iu bashkëngjitën skuadrës së pushkatimit politik ndaj Isa Mustafës i cili, deri në çastin kur i shkuan puplat e kryeministrit, sillej sikur shqiponjë, ndërsa mbeti pastaj si një pulë e ndukur, e ngrirë dhe e shkrirë shumë herë në frigoriferët e oligarkucit të kësaj partie, Ramizit, vëllait të Boros, nga Lista Serbska. Realisht, ishin disa individë nga LDK-ja që jetësisht ishin të interesuar të dobësohej politikisht Isa Mustafa në mënyrë që ata ta merrnin drejtimin e kësaj partie e cila asnjëherë nuk doli nga kornizat dhe përmbajtja nga koha kur ishte themeluar,

Lidhjes Socialiste e Popullit Punonjës të Jugosllavisë. Përkundër kësaj, disa individë, me të kaluar të kristaltë jugosllave, "filozofinë" politike e ndërtonin mbi urrejtjen ndaj luftës çlirimtare të UÇK-së dhe vlerave të mirëfillta kombëtare, ndërkohë që deklaroheshin si parti e djathtë e (djathtë) apo parti kombëtare. Zërat më të fuqishëm kundër çdo vlerë kombëtare ishin ata që e bojkotuan varrimin e viganit të luftës për liri dhe çlirim kombëtar si dhe për bashkim me Nënë Shqipëri, të Pavdekshmin Bacë Adem Demaçi sikur që nuk lanë rast pa e sulmuar komandantin legjendar të UÇK-së, të Amshueshmin Adem Jashari. Kotilla e dalë nga Majka Jugosllavi dhe Majka Serbi nuk kanë si të veprojnë ndryshe. Pamja mund të ndryshojë, trashëgimia nënshtruese e kodifikuar në gjene nuk ndryshon asnjëherë. Tash, për zgjedhje të parakohshme janë çuar peshë LDK-ja dhe LV-ja me shpresë se do t'i fitojnë lehtësisht këto zgjedhje sikur që, për taksirat të saj, më parë ishte çuar peshë PDK dhe e cila e mori një të goditur të fuqishme hundëve të cilat i kruan edhe sot e kësaj dite. Po, ta shohim si do të ishte radhitja dhe gjasat e subjekteve politike në rast se do të mbaheshin zgjedhjet e parakohshme, në afatin gjashtëmujor ndonëse nuk besoj se do të ketë zgjedhje, së paku jo para qershorit të vitit 2019 si dhe koalicionet e mundshme.

1. Lidhja Demokratike e Kosovës, si kërkuesja kryesore për zgjedhje të parakohshme po shpreson se lehtë i fiton zgjedhjet ndonëse është bërë si një ekonomi familjare, më 10 kuleta. LDK-ja nuk ka udhëheqës dhe udhëheqje që e ka besimin e partisë. Isa Mustafa, lideri aktual, përkundër vullnetit që po e ka për tejkalimin e gjendjes shëndetësore e cila, përkundër përmirësimit e që mua më vjen mirë që e ka shëndetin më stabil (vetëm të poshtrit e LDK-së gëzohen me fatkeqësitë e atyre që i kon-

siderojnë, jo kundërshtarë politikë por armiq personalë), nuk e ka përkrahjen të këtij subjekti politik për faktin se, së paku 10 kandidatë për postin e kryetarit të LDK-së i rrinë me shpatë mbi kokën e tij politike me qëllim që t'ia shkurtojnë kokën politike të Isa Mustafës. Edhe në diasporë, Isa Mustafa ka më shumë që e kundërshtojnë sesa që e përkrahin. Duket se Isaja, me testament e ka caktuar që pasuesi i tij të jetë Komandant Dulla, ai nuk po pranohet nga askush që ka emër dhe mbiemër politik në LDK-së.

E keni parë që në konferenca me peshë për LDK-në, prononcimet bëhen nga Agim Veliu i cili, për kundërshtarë më të fuqishëm brenda LDK-së e ruan shkopin e bejsbollit kurse për çiftin e Dullës, Lutës e do eurokremave politikë e ka një thupër shelgu e cila, dëmin më të madh që mund të shkaktojë është skuqja e bythëve, në rast se i theksojnë jashtë kufijve të përcaktuar nga Agimi, Haku dhe elefantët e tjerë të LDK-së. Dritonin, Lumin dhe do jeniçerë të LDK-së i rehaton me disa shpulla me forhend dhe bekhend. Gjenerata e vjetër e LDK-së, në asnjë mënyrë nuk do të lejojë që ata të spostohen nga udhëheqja dhe për këtë është në gjendje të bëjë koalicion, jo vetëm me PDK-në, por edhe me dreqin dhe të birin vetëm të mbesin në pushtet, afër pushtetit apo në shërbim të pushtetit. Këtë e kanë dëshmuar në vazhdimësi, dhe, si parti tradicionaliste që janë, ashtu do të vepronin edhe pas zgjedhjeve të parakohshme eventuale. Koalicioni parazgjedhor me LV-në janë "përralla të një nate vere" sepse do ta kishin vështirë, mos ta them të pamundur ta ndajnë pushtetin. LDK-ja, pa profilizim politik dhe pa u distancuar nga e kaluara jo fort e lavdishme kombëtare, e ka vështirë t'i shtyjë proceset politike më tej por se është drejt rrugës së ndarjes dhe, si përfundim, drejtimin e kësaj partie mund ta marrin personat me një të kaluar kurrë (v)fare politike dhe kombëtare.

LDK-ja është parti që vajton për aktivistë të saj të vranë, në rrethana të pasqaruara dhe për të cilët nuk ka bërë asgjë përveç se ka përfituar vota në saje të tragjedi të tjerëve. LDK-ja ka qenë në pushtet, ka pasur një kohë të gjatë ministra të drejtësisë dhe për punë të brendshme dhe nuk ka bërë asgjë për zbardhjen e rasteve të aktivistëve të saj që janë vranë në rrethana të pasqaruara, deri më tani. Mund të gaboj, por, disi më duket se LDK-ja nuk është aspak e interesuar të zbardhë fatin e aktivistëve të saj të vranë apo të zhdukur gjatë dhe pas përfundimit të luftës. LDK-ja, në zgjedhjet eventuale të parakohshme mund të fitojë më së shumti 23 për qind të votave që mjaftojnë të dalin partia fituese por se do të detyrohej "të shkërdhehej në shtratin e koalicionit me të gjithë kurvarët politikë, të regjur në këtë zeje", për ta marrë postin e kryeministrit apo për të mos shkuar në opozitë. Ky do të ishte fillimi i fundit të LDK-së me ç'rast elefantët e vjetër do të vdisnin politikisht apo në Dubravë ose në Burg për Siguri të Lartë, partia do të përçahej shumë dhe as deputetët e kësaj partie nuk do t'i bindeshin partisë, për dikë parti mëmë kurse për disa parti njerki! Për LDK-në do të ishte shumë më mirë të mos ngarend pas pushtetit dhe pas postit të kryeministrit por të mbetet edhe kësaj radhe në opozitë, ama opozitë konstruktive, të reformohet nga brenda, të profilizohet politikisht dhe strategjikisht, duke u liruar nga "mishi i keq" dhe, pas këtij procesi të mundshëm por të domosdoshëm, në zgjedhjet e ardhshme do t'i fitonte, me siguri, mbi 35 për qind të votave. Kështu, nëse vazhdon në këtë mënyrë do të shërbejë për përmbushje të epsheve politike të kurvarëve me përvojë dhe kurvarëve në pritje që nuk do ta lironin nga shtrati i Prokrustit (koalicionit, pa e shkërdhyer mirë e mirë.

2. LV-ja është ajo që, përkrah LDK-së bënë thirrje për zgjed-

hje të parakohshme duke shpresuar se do të dali partia e parë apo, duke flirtuar me LDK-në do të fitojë zgjedhjet, do ta bëjë Albinin kryeministër, do t'i fusë në burg, pasi t'i ketë eliminuar politikisht këta të partisë të Kaçusha Jasharit, e ambalazhuar si parti e Shpendit. LV-ja, përballë PSD-së po sillet pikërisht si një dem mashkull shqiptar që, pasi të jetë ndarë nga e dashura apo gruaja, në vend se ta ruaj një respekt dhe mundësi për bashkëpunim, e sulmon si prostitutën më të madhe ndonëse as vet nuk është asgjë me i mirë. Të rrallë janë ata meshkuj që e ruajnë dinjitetin pasi të jenë ndarë nga të dashurat apo pasi të jenë lënë nga to. Kam një përshtypje që LV-ja, në zgjedhjet e ardhshme të parakohshme, nëse ato mbahen e unë nuk besoj se do të mbahen, më shumë kohë do të shpenzojë duke e sulmuar PSD-në, se sa partitë tjera e që do të ishte gabim i kushtueshëm dhe strategjik. Pikërisht kjo armiqësi do ta dërgonte LV-ja drejt koalicioneve, që në rrethana normale nuk do t'i bënin. LV-ja nuk do t'i fitonte më shumë se 18-20 për qind të votave.

3. PDK-ja sot është shndërruar në parti tipike të biseksualitetit politik; Kadria e mbanë, Hashimi i kërcen apo e shalon! Kjo i ka kushtuar në zgjedhjet e fundit, kjo do ta dëmtojë edhe më shumë në të ardhmen nëse nuk bëhen ndryshime të thella të cilat, sigurisht se shkaktojnë dhembje në çastin e intervenimit kirurgjik por, nëse mbi-jeton këtë intervenim, ka gjasa për këndellje. Deri më tani PDK-ja, në vend se të bëjë intervenime të thella kirurgjiko-politike, kryesisht është marrë me syneti; ka hequr lëkurë pas së cilave kanë dalur probleme edhe më të mëdha sikur te fëmijët e vogël pas synetisë, e heq lëkurën dhe del diçka edhe më e madhe që deri atëherë nuk dukej fare. PDK-ja duhet të lirohet nga ata që Partinë Demokratike të Kosovës e kanë shndërruar në

Partinë e Dubravës të Kosovës duke u arsyetuar se akronimi për të dyja rastet është i njëjtë, PDK. PDK-ja ka problem me granim në këtë parti sepse figurat e njëjta janë të parapaguara në postet e deputeteve ndonëse nuk kanë një kapërcim kualitativ të dijeve politike sikur edhe një numër i madh i burrave. PDK-ja duhet t'ua krijojë mundësitë për konkurrencë atyre që kanë dije politike, pastërti njerëzore, kombëtare, morale dhe profesionale e jo ta institucionalizojë nepotizmin duke ricikluar të padijshëm me arsyetim se nga Skenderi del Skenderi e, në fakt, nga beteri po dalin betera të ricikluar (në disa raste) që po e dëmtojnë pariparueshëm këtë parti, e cila për këto arsye është në rënie e sipër.

PDK-ja duhet të lirohet nga ata që i përshtaten çdo lideri, për një post të mjerë, e që nuk e ka bërë deri më tani. PDK-ja nuk mund të veprojë sipas parimit të shokut Zulo, nëse ka për qëllim të jetë një parti konkurruese në të ardhmen. Kadri Veseli, nëse mendon të bëhet lider i vërtetë, duhet të bëjë reforma të thella, duhet të marrë vendime me risk sepse vetëm ato e bëjnë lider, duhet ta respektojë Thaçin si president por jo si "ortake" në PDK dhe, më shumë duhet të bëhet gati për opozitë sesa për pozitë, me kusht që zgjedhjet të mbahen në gjashtë muajt e ardhshëm. Për mendimin tim, më mirë do të ishte, për shëndetin politik të Kadri Veselit edhe të tërhiqet krejt nga udhëheqja politike e kësaj PDK siç është, sesa ta vazhdojë vdekjen e ngadalshme, por të pashmangshme politike nëse nuk e merr në duar bistrinë e një kirurgu të vendosur dhe profesionist. Llaskucët dhe kurvat politike nuk i bëjnë nder aspak, përkundrazi, ata janë dhe do të jenë pjesë e kortezhit të funeralit të tij politik. Nuk ka asgjë më keq dhe më e dëmshme se kur miqësia private shndërrohet në parim politik. Për ta ilustruar këtë e marr shembull konkret, nëse aty ku punoni apo veproni dhe ku jeni njëshi e keni një të dashur, mashkull apo femër qoftë, fundin do ta keni sikur në ferrin e Dante Aligerit. Me këtë brumë që aktualisht e ka Kadri Veseli në PDK, edhe nëse përpigjet ta gatuj një fli, më së shumti që do të arrijë është të dali një kryelanë e qullët dhe e papjekur. Politikisht është shumë gabim që të vizatoni vija të kuqe në bazë të paragjytimeve sikur që është gabim të jeni të hapur për të gjithë vetëm për shkak të pushtetit. Vijat e kuqe vlejën vetëm për çështje të mëdha dhe të rëndësishme kombëtare dhe shtetërore e, për fat të mirë, asnjë parti apo lider në

Kosovë nuk e ka këtë ngarkesë përveç AKR-së, Behgjet Pacollit dhe Hashimit e që nënkupton se janë pakicë absolute! Edhe në këto rrethana të cunamit brenda PDK-së, mund të llogarit në 20 për qind të votave apo luftë për vend të tretë me LV-në.

4. AAK-ja edhe në të ardhmen do ta luaj rolin që e luan LSI-ja e Ilir Metës në Shqipëri duke qenë përcaktuese për koalicionin dhe formimin e qeverisë. E ka forcuar pushtetin lokal dhe në zgjedhjet e parakohshme eventuale mund të llogarisë në 10 -12 për qind të votave. 5. Nisma për Kosovën e ka tejkaluar premtimin elektoral se çdo familje do ta ketë së paku nga një të punësuar duke punësuar edhe më shumë, me kusht që të jenë anëtarë të Nismës. Madje, ka punësuar edhe ata që mendojnë të bëhen anëtarë të këtij subjekti politik. Vota klienteliste do t'i sjell kësaj partie 6-8 për qind dhe nuk do ta ketë problem ta kalojë pragun zgjedhor.

6. AKR-ja apo parti e Kolektivnaja Hajzajstvo (Koopërativa e Bujqësore të Rusisë dhe Shqipërisë së dikurshme) do të hyjë në koalicion parazgjedhor me të gjithë vetëm të mos përjashtohet nga moçali politik dhe biznesor. Nëse shkon e vetme në zgjedhje e për çka nuk besoj, atëherë, më parë do ta kalojnë pragun zgjedhor Boni dhe Klajd e Alternativës, së AKR-së.

7. Nëse zgjedhjet mbahen brenda gjashtë muajve besoj se edhe Kaçusha, me Shpendin do ta kalojnë pragun zgjedhor dhe se Kaçushën do ta keni deputete, çmim ky i dakorduar për huazimin e emrit dhe strukturave gjigante të kësaj partie.

Për mua do të ketë shumë rëndësi me kënd do të bëjnë koalicionin partitë e Luginës së Preshevës.... pasi Hashimi ta ketë bashkuar Luginën, pa ia dhënë as kontejnerët e mbeturinave të Veriut të Kosovës e lëre më tërë Veriun siç po mendojnë skeptikët e Kosovës apo optimistët e Vuçiqit Hahahahahahahahaha! Po e përsëris, nuk besoj se do të ketë zgjedhje mirëpo nëse ato mbahen në këtë afat gjashtëmuajor, këto do të ishin rezultatet e përafërta, plus - minus 1,5 për qind margjina e gabimit që lejohet në këto analiza sikur që në Kosovë ligjërisht është e lejuar plagjiatura deri në 69 për qind, jo më shumë sepse, ndryshe do t'ua mohonin autorësinë e një punimi!

Mirëpo, sido që të jetë rezultati, në Kosovë nuk do të ketë ndryshime sepse proceset politike janë kundër ndryshimeve sikur edhe subjektet politike që iu nënshtrohen këtyre proceseve.



Koleksionistja britanike ekspozon 37 botime për Skënderbeun

PRISHTINË, 15 TETOR - Është hapur ekspozita e titulluar "Jeta dhe kohërat e Gjergj Kastriotit - Skënderbeut, heroit kombëtar shqiptar", në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës, me ç'rast është prezantuar koleksioni i librave të koleksionistes së njohur britanike, Patricia

Nugee. Britanikja Patricia Nugee ka thënë se është e kënaqur që iu dha rasti ta ekspozojë koleksionin e librave për Skënderbeun në Prishtinë. "Nuk do t'ju jap sot një mësim historie sepse nuk jam historiane. Për herë të parë dëgjova

për Skënderbeun përmes një klienti kur punoja në një librari antike në Londër", ka thënë ajo. Ndërsa këshilltari i kryeministrit të Kosovës, Jahja Lluka, ka vlerësuar lart koleksionin e Patricia Nugee dhe ka thënë se Kosova do të jetë e përkushtuar që t'i ruajë miqtë gjithmonë.



Haradinaj: Ramë Lahaj ka lartësuar emrin e Kosovës në qendrat botërore të kulturës

PRISHTINË, 15 TETOR (ER) - Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, ka prituri të hënën në takim tenorin Ramë Lahaj, me të cilin kanë folur për angazhimin e tij të madh, për ruajtjen dhe avancimin e vlerave kulturore. Me këtë rast Haradinaj ka thënë se Lahaj ka

lartësuar emrin e Kosovës në qendrat më të njohura kulturore në botë. "Tenori prestigjioz Ramë Lahaj, përpos që ka arritur majat personale të suksesit, ka lartësuar emrin e Kosovës në qendrat më të njohura kulturore në botë. Kënaqësi e veçantë të flisnim për

angazhimin e tij të madh, për ruajtjen dhe avancimin e vlerave kulturore dhe të këmbenim mendime rreth ndërtimit të sallës koncertale, e cila do të jetë strehë ku artistët do t'i shpalsin veprat e tyre", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Pas disfatës në Bavari, Merkeli premton ta rifitojë besimin



BERLIN, 15 TETOR - Kancelarja gjermane, Angela Merkel, tha të hënën se humbja e madhe e aleatëve të saj konservatorë në rajonin e Bavarisë tregon se votuesit e kanë humbur besimin në qeveri dhe premtoi se do të luftojë për ta rifituar atë. "Mësimi im nga kjo është se unë, si kance-

lare, duhet të siguroj rikthimin e besimit. Do të punoj për këtë me gjithë energjinë që kam", tha Merkel në një ngjarje të përfaqësuesve të industrisë gjermane. Komentet vijnë pasi partia simotër e Merkelit pësoi të dielën humbje të madhe në zgjedhjet shtetërore të Bavarisë, duke

shkaktuar pasiguri në koalicionin qeverisës. Me gati të gjitha votat e numëruara, Unioni i Krishterë Social humbi shumicën absolute në Parlamentin e Bavarisë, të cilën e ka që nga viti 1957. Të Gjellbrit u ngritën në vendin e dytë, ndërsa partia anti-migrante

Alternativa për Gjermaninë do të futet për herë të parë në Parlamentin bavarez. Sipas analistëve, shoqëria gjermane ka nisur të ndahet thellësisht që nga viti 2015, kur Merkel ka hapur dyert e Gjermanisë për mbi një milion migrantë, kryesisht myslimanë nga Lindja e Mesme.

Katharina, liderja e re që mposhti 'gardën e vjetër' në Gjermani

Katharina Schulze, fituesja e vërtetë e zgjedhjeve në Bavari, ka një retorikë pasionante dhe si udhëheqëse e të Gjellbërve në Parlamentin rajonal është një nga dy kandidatet kryesore të partisë. Schulze ka studiuar psikologji dhe politikë, teksa mësoi se si të bënte fushatë në ShBA në vitin 2008, pas zgjedhjeve të para presidenciale të Barak Obamës



BERLIN, 15 TETOR - Katharina Schulze është fituesja e vërtetë e zgjedhjeve në Bavari, aty ku CSU-SPD rrëshqitën në nivele historike të humbjes së votave, duke shokuar edhe vetë kancelaren Merkel. E re, e buzëqeshur dhe me një retorikë pasionante, udhëheqëseja e të Gjellbërve në Parlamentin rajonal është një nga dy kandidatet kryesore të partisë, së bashku me Ludwig Hartmann. Schulze ka studiuar psikologji dhe politikë teksa mësoi se si të bënte fushatë në ShBA në vitin 2008, pas zgjedhjeve të para presidenciale të Barak Obamës. E specializuar në politikën e

brendshme, ajo mbart një pozicion të parregullt për të Gjellbrit. Ajo synon vendosjen e më shumë policëve në rrugë, për të garantuar një shtet të së drejtës dhe të fortë në të njëjtën kohë, me "policinë në kufijtë bavarezë që duhet të ketë parasysh se ne jetojmë në një Evropë të bashkuar". Rritja meteorike e saj përshkruhet si e shkëlqyer në qarqet e politikës gjermane, me Katharina që shihet si "Merkeli" i ri pavarësisht se idetë e qeverisjes së vendit i kanë të kundërta. Në 9 vjet ajo ka shkruar nga të qenit një e sapo regjistruar në seksionin e të rinjve të Verdit në 2008 të kryetare e partisë në parlamentin

e shtetit federal në vitin 2017. Për pjesën tjetër ajo është në përputhje me temat tradicionale të partisë suaj. Cilësia e ajrit dhe uji, bujqësia e qëndrueshme, pensionet e garantuara minimale.

Lidhur me çështjen e migrimit, që ndihet fort në Bavari, motoja e Schulze është se "fenomeni është shtyrë dhe nuk është administruar si duhet", dhe në veçanti Ankerzentren, një lloj specifik i

qendrave pritëse për emigrantët, nuk është një zgjidhje e dëshirueshme, sepse ato pengojnë integrimin në vend të favorizimit të tij. Schulze ka bërë një fushatë elektorale me "5 Yje" do të thoshim, pa humbur ndonjëherë një takim dhe gjithmonë me një mikrofon në dorë. Vajzë me prezencë, e kanë përcaktuar mediet. Një talent i vërtetë për komunikimin. Rrethi bavarez i folësve në gjermanisht (VrdS) ranë dakord se ajo ishte kryetarja më e mirë në zgjedhjet bavareze të 2018-s. Asgjë personale rreth jetës së saj nuk dihet, përveç se ajo nuk është e martuar, nuk ka fëmijë dhe nuk ka lindur në Bavari, por në Freiburg në Baden-Wuerttemberg. Kandidatja e të Gjellbërve ndan rolin e saj me 40-vjeçin Ludwig Hartmann, pasi është praktikë standarde në parti që të ketë një kandidat të dyfishtë. Por sigurisht që ajo është ylli i ri në rritje i grupit dhe politikës gjermane në tërësi.

Trumpi: Putini 'ndoshta' është përfshirë në vrasje!



UASHINGTON, 15 TETOR - Presidenti amerikan, Donald Trump ka thënë në një intervistë televizive se beson që homologu i tij rus, Vladimir Putin "ndoshta" është përfshirë në vrasje dhe ka pohuar sërish se Moska ka ndërhyrë në politikën amerikane. Trumpi, po ashtu, ka thënë se nuk e di nëse Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Jim Mattis është duke planifikuar të dorëhiqet, mirëpo se ai e konsideron gjeneralin si "lloj të demokratit" dhe se ai

mund të largohet. Ai i ka bërë këto komente në një intervistë të realizuar paraprakisht për emisionin televiziv 60 minuta në CBS, e cila është transmetuar më 14 tetor. Në mesin e çështjeve që ai ka përmendur janë edhe Koreja Veriore, përpjekjet e shpëtimit pas uraganit në ShBA, zhdukja e gazetarit saudit në Turqi, Jamal Khashoggi dhe ndryshimet klimatike. Kur prezantuesja e CBS-së, Lesley

Stahl, e ka pyetur Trumpin nëse pajtohet me njerëzit që pretendojnë se Putini ka qenë i përfshirë në vrasjet e kritikëve, ai është përgjigjur, "ndoshta po. Ndoshta". Nuk është bërë e qartë se në cilat vrasje Trumpi ka dyshuar se ka qenë i përfshirë Putini, ndonëse shumë kritikë të liderit rus janë vrarë përmes helmimeve të dyshuara dhe të tjerë në kushte të mistershme. Megjithatë, Moska ka mohuar ndonjë lidhje.

Britania dhe BE-ja dështojnë në arritjen e paktit për Brexit

LONDËR, 15 TETOR - Britania dhe Bashkimi Evropian kanë dështuar të arrijnë një marrëveshje për Brexitin në bisedimet e paplanifikuara vetëm disa ditë para samitit vendimtar të BE-së. Në një takim më 14 tetor në mes të negociatorit të BE-së, Michel Barnier dhe Sekretarit britanik për Brexit, Dominic Raab, së bashku me 27 ambasadorë tjerë evropianë në Bruksel, është spekuluar arritja e

një marrëveshjeje të mundshme për t'i vendosur kushtet e largimit të Britanisë nga BE-ja. Mirëpo Barnier ka thënë përmes një postimi në "Twitter" se "pavarësisht prej përpjekjeve të vazhdueshme, disa çështje kyçe janë ende të hapura". Ai ka thënë se çështja që ndan të dyja palët është nevoja e "anashkalimit të një kufiri të ashpër", në mes të Irlandës Veriore në Britani dhe

Republikës së Irlandës pas Brexitit. Qeveria Britanike ka thënë se ende ka "çështje të pazgjidhura", mirëpo ka insistuar se negociatorët kanë bërë "përparim të vërtetë", drejt arritjes së paktit. Irlanda është anëtare e BE-së dhe aktualisht ekziston një "kufi i butë" në mes të këtij vendi dhe Irlandës Veriore, pa formalitete doganore.



Recension

Një panoramë e aspekteve të jetës shkrirë në vargje poetike

(Bilall Maliqi, "Ëndrra që më dha gëzim", Sh. B. "Lena", Prishtinë, 2018)

Dr. Rovena VATA

Në këtë libër kushtuar botës së pafajshme, pra letërsisë për fëmijë, autori bën pjesë të këtij libri çdo poezi, që lidhet me botëkuptimin e çdo fëmije, duke iu përshtatur zhvillimit të tij psiko-filozofik. Në çdo poezi jep nga një mesazh tepër domethënës autori, kjo si qëllim për të pasur njohuri, mbi jetën, natyrën, historinë, personalitetet kombëtare, që çdo fëmijë duhet t'i marr përmes librave dhe aq më tepër përmes botës së poezisë.

Bilall Maliqi e fillon librin e tij me një poezi të dedikuar mbesës së tij për ditëlindje Klestës, për një vjetorin e lindjes së saj, duke i uruar jetëgjatësi me urimin, që të jetojë sa malet.

Autori jep një panoramë të të gjitha aspekteve të jetës, duke i mësuar fëmijët edhe me stinët e vitit dhe me mjetet që na duhen për tu mbrojtur në çdo stinë, për fëmijët stina më e bukur, por edhe ajo që duhet të kemi më kujdes është ajo e dimrit, pasi bie borë dhe fryn egër veriu, dhe duhet të sigurohemi për të mos pasur ftohtë, këtë autori e pasqyron në poezinë /Më ka humbur dorëza/.

Gjumi është mënyra më e shëndetshme që fëmijët të rriten të bukur dhe të shëndetshëm, prandaj autori i kushton një poezi pikërisht të titulluar "Gjumi". Ninullat janë tingujt e parë që ushqehet shpirtërisht dhe artistikisht një fëmijë.

Për t'u vlerësuar është edhe fakti se autori nuk harron emrat tipikë shqiptar të fëmijëve, pasi në botën e sotme ka filluar të zhduket ky zakon dhe emrat shqiptarë të zëvendësohen me emrat tipikë të huaj evropiane ose amerikane. Emrat shqiptar që bien në sy më shumë janë emrat si: Ilir, Trim, Drini, Yllka, Besa, Lis, Era etj.

Autori jo pa qëllim e bën poezi fjalën ilir, për të treguar përmes fjalës, përmes poezisë dhe përmes ritmit se kush jemi, nga ku i kemi rrënjët, çfarë identiteti kemi dhe kush na përfaqëson.

Fëmijët dihet se në moshën e tyre më të mirë e mësojnë çdo gjë përmes pyetjeve: pse, kush, cili, dhe durimi i çdo njërit prej nesh është tu japim përgjigje sa më të sakta dhe të lehta, që ata ta perceptojnë për atë çka ata pyesin, e kush më mirë se gjyshërit kanë më shumë durim të merren dhe të mësojnë nipërit dhe mbesat e tyre. Kot nuk thotë populli se: "Fëmija i fëmijës është mjalti i mjaltit.

Në një pyetje që fëmija i drejton gjyshit të tij, kush është iliri? Gjyshi i përgjigjet kështu:

*Iliri, ime bijë,
Është prejardhja jonë
Fisat para tij,
Pellazg i thonë!*

*Ata kanë jetuar,
Edhe n'këto troje
Dhe kanë pirë ujë,
Në t'maleve kroje!*

Ilirët janë gjaku ynë, janë të parët tanë, janë prejardhja jonë arbërore. Gjurmët më të vjetra dihet se janë në libra, dorëshkrime apo në gjërat e moçme, siç janë kalatë, ku gjyshi i sugjeron nipit të tij se hajde shkojmë në kala, atje mund të gjejmë gjurmë ilire, pra duke i mësuar nipit dhe po kështu të gjithë brezit të ri se gjurmët tona duhet kërkuar në rrënojat më të lashta, në lashtësi e kemi origjinën dhe zanafillën të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen.

Autori për të treguar për shenjtorin shqiptarë që e njohi mbarë bota dhe shpërndau kudo ku shkela këmba e saj vetëm, mirësi, përkujdesje dhe dashuri, pra Nënë Tereza, ai ia kushtoi këtë poezi: /E kujt është kjo shtatore/. Për kureshtjen e fëmijëve se e kujt ishte ajo shtatore që i dukej sikur e shikonte, por nuk fliste, gjysha i përgjigje:

Ajo është nëna plakë, është nëna e gjithë botës, që ka bërë bamirësi në gjithë rruzullin tokësor.

*"Si e ka emrin gjyshe,
Ç'shkruan në atë pllakë
Të mësoj sot dua,
Për këtë Nënë plakë!"*


*Emrin e ka Gonxhe,
I thonë Nëna Terezë
Ka ndihmuar të varfrit,
Në atë kohë të zezë!"*

Poezia: "E kujt është kjo shtatore" Loja është mënyra më e mirë për fëmijët për të mësuar çdo gjë në jetë, përmes lojës ai mëson dhe argëtohet shumë, gjithashtu edhe autori na e kujton sesa e rëndësishme është loja për fëmijët dhe sidomos futbollit dhe mënyra e lojës së tij.

*"Nuk lëshon gol,
Ky portieri i ri
E mbron portën,
Për mrekulli!
Në shumë lojëra,
Me kundërshtarë
Është zgjedhur,
Gjithmonë i parë!
Ky është Noari,
Përplot krenari
Është me prejardhje,
Nga e jona Malësi!"
Poezia "Portier Noari"*

Simbolet kombëtare nuk janë jashtë vëmendjes së këtij autori, siç është flamuri i shtetit të Kosovës, ku i kushtoi poezinë me titull: "Ç'është ky flamur". Kjo poezi është shkruar me rastin e 10-vjetorit të shtetësisë së Kosovës.

Poezia që në titull fillon me një pyetje habitore, ç'është ky flamur, me gjashtë yje, sikur të ishte marr



në ndonjë pyll a mal. Shqiptarët kudo që ndodhen janë mësuar me flamurin e tyre shqiptar, me fushën e kuqe dhe shqiponjën dykrenore, dhe ky flamur i krijuar jashtë dëshirës së shqiptarëve, që jetojnë në Kosovë dhe në Luginën e Preshevës, ku autori e cilëson faktin se ai është një flamur i sajuar nga të huajt pa dëshirën e tyre.

*"Ky flamur i kaltër,
Është i shtetit tonë
Na kanë krijuar të tjerët,
Jashtë dëshirës sonë!"*

*Nipi që e njej flamurin që të parët
ia kanë lënë, pyet gjyshin e tij se
pse ia zuri vendin ky flamur, flama-
murit të tyre.*

*"Ç'u bë gjysh të lutem,
Ku është i yni Flamuri,
Që valonte çdo ditë,
Pse tjetri vendin ia zuri?"*

Dhe gjyshi i përgjigjet nipit:

*"E hoqën bir i gjyshit,
Në të dhjetin përvjetor
E ngritën të shtetit,
Deri në të lumin Nëntor!"*

Autori nuk harron pa kujtuar brezave të rinj se guri i rëndë peshon në vendin e tij, e jo në vendin e huaj, kështu dhe ai shkruan poezinë me titull: "E dua vendin tim", duke kujtuar se e do vendin e tij për të mirat që ka dhe për të mirat që ai i ofron.

*"Të dua vendi im,
Me kodra përreth
Ke ajër të pastër,
Me të mirin shesh!"*

*Të dua vendi im,
Me lumin gjarpëror
Fushat dhe pyjet,*

Gëzim shpirtëror!"

Urimin dhe bekimin më të madh autori e jep përmes poezisë me titull: "Bëhu si lisi". Simboli i lisis me cilësitë e tij, i lartë, i drejtë, krenar, i bukur, i fortë dhe plisi simbol i identitetit kulturor dhe element i trashëgimisë shpirtërore ndër breza.

*"Lis, bëhu si lisi,
I fortë në çdo furtunë
As era e trazuar,
Shtatin mos ta lëkund!"*

*U rritsh e u bëfsh,
I gjatë sikur ai lis
Të shkëlqejë në kokë,
I bardhi ynë plis!*

*Puno pandërprerë,
Të lutem biri im
Për atdheun tonë,
Merre emrin Trim!"*

Ajo çfarë nuk është harruar në këtë libër për fëmijë është sjellja e një poezi edhe për bacë Jasharin (Adem Jasharin-dëshmorin e luftës për liri të Kosovës).

*"Sa dua ta shoh,
Atë njeri që s'flet
Rri i heshtur,
Duket pors mbret!"*

*I fortë si guri,
Rrëfente gjyshi im
S'i trembej dot syri,
Ishte shumë trim!"*

*Nëpër luftëra e beteja,
Gjithmonë i pari
Përballë me armikun,
Ishte legjendar!"*

*Moti kishte humbur,
E shtrenjta liri
E solli kryetrimi,
U fut në histori!"*

Te poezia "I shkreti lypsar" autori na ngjan me tregimin e Migjenit "Luli i vocërr", ku jep pamjen e mjerë të lypsarit që gjendet kudo në rrugë, duke kërkuar lëmshë.

*"Në udhën tonë,
Lypsa duarshtirë
Kërkon lëmshë,
E ka jetën e vështirë!"*

*Përditë i njëjti vend,
Të lekosur e pret
Me fytyrë të zverdhur,
Koha ngadalë e vret!"*

*Lypsa i ngratë,
I shkreti fatzi
Me xhepa të zbrazur,
Kthehet në shtëpi!"*

Ajo çka ia shton lezetin dhe hijeshinë këtij libri është leksiku, fjalë të gjuhës shqipe që mbartin kuptim dhe autori ua gjen vendin në tekst, fjalë të pasura të fondit të shqipes, që duhet të mësojë çdo fëmijë shqiptar, kudo që të ndodhet, bashkë me kuptimet që fjala mbartë, ku si të tilla mund të përmendim fjalët:


Engjëll, bekon, mbretëreshë, gjysh, gjyshe, dëshirë, plotëson, hare, fytyrë engjëllore, djepi me lula, lulëgjaku, fustanverdha faqeukuqe etj etj., apo fjalët dhe shprehje tipike shqiptarë të tipit: Kjo ditë e lume, Të rrojë sa malet, Në gjuhën e vet, Veç me urata e bekon etj.

Ky libër me poezi për fëmijë i shkrimtarit Bilall Maliqi, zë vend me rëndësi në letërsinë për fëmijë, duke u bazuar në vlerën e arritjeve artistike të poezive që ka brenda librit dhe me këtë autorit i urojmë frymëzime të reja në fushën e poezisë së këtij ligjërimi dhe në krijimtarinë e gjithëmbarshme të tij.

E jashtëzakonshme

Karrige me rrota edhe për breshkat e dëmtuara

Ekipi veterinar i kopshtit zoologjik të Marylandit në Baltimore, ShBA, ka ndërtuar një karrige me rrota me tulla për të ndihmuar një breshkë që i ishte thyer zhgualli. Dr. Ellen Bronson shpjegoi se kafsha kishte thyerje të shumëfishta. "U ballafaquam me një sfidë të vështirë, duke ruajtur lëvizjen e breshkës, duke e lejuar atë të shërohet", tha ai. Veterinarja Garrett Fraess, një



studente e vitit të katërt, arriti me idenë e karriges me rrota. "Kam hartuar disa skica për një karrocë të personalizuar, pastaj i dërgova te një mik", ka treguar ajo.

FOTO E DITES



Një mace gjatë Festës Ndërkombëtare të Maceve në Ankara të Turqisë. /AFP/

E rrallë

Vidhet trupi i viktimës së Ebolas gjatë funeralit

Të afërmit e një gruaje të vdekur nga Ebola kanë organizuar një komplot të guximshëm për ta marrë trupin e saj. Ata rrëmbyen makinën e funeralit dhe më pas morën arkivolin me trupin e viktimës në Republikën Demokratike të Kongos. Sipas Ministrisë së Shëndetësisë,



trupin i përkiste një gruaje që vdiq në Qendrën e Trajtimit të Ebolas, që ndodhet në pjesën verilindore të vendit.

BARSOLETA E DITËS



Një burrë në tren i thotë pasagjerit tjetër në krahë.
- Po ti them disa barsoleta me policë.
- Vetëm kujdes, se unë jam polic.
- S'ka gjë, se ti them dalëngadalë.




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

"ALPHA" 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson
Regjia: Albert Hughes

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

"JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN"

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.
Regjia: David Kerr



Në ora 18:00

"NIGHT SCHOOL"

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.
Regjia: Malcolm D. Lee



Në ora 20:00

"SIBERIA",

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.
Regjia: Matthew Ross



Në ora 22:00

"VENOM" 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.
Regjia: Ruben Fleischer
Based on the Marvel Comics



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: **Kino ABC**.

 <p>DASHI Iniciativat që ndërmerrni shumë herë varen nga pasioni me të cilin i përballoni. Këto të fundit do të rezultojnë shumë fitimprurëse për ju.</p>	 <p>DEMI Falë Marsit në shenjën tuaj jeni mjaft determinues dhe të gatshëm ta mbronni çdo ide tuajën pa asnjë hezitim.</p>	 <p>BINJAKËT Keqkuptimet në shumë drejtime po krijojnë mjaft tension në jetën tuaj. Duhet të filloni ta menaxhoni stresin dhe të tregoheni më të qetë me të tjerët.</p>	 <p>GAFORRJA Nëse ju duhet të përballoni një debat me një person të rëndësishëm sot, mundohuni të mos udhëhiqeni nga emocionet, por arsyetoni qetësisht.</p>	 <p>LUANI Sot do të bini pre e nervozizmit dhe do të prishni gjithçka që keni ndërtuar me aq mundëri tani. Në familje situatat nuk paraqiten dhe aq të qeta.</p>	 <p>VIRGJËRSHA Mërkuri në shenjën tuaj jeni mjaft të predispozuar për marrëveshje të reja biznesi që do të sjellin përfitime të mira.</p>
 <p>PESHORJA Do të jeni shumë intuitiv sot dhe siguritë tuaja të brendshme do të sjellin mjaft qetësi shpirtërore. Ju ka kapur një fazë e qetë në jetën tuaj.</p>	 <p>AKREPI Të falësh dikë që ka gabuar pa dashje është shumë më e lehtë se t'i drejtosh gishtin për gabimin e kryer. Do të arrini të neutralizoni një problem.</p>	 <p>SHIGJETARI Edhe pse sot ndiheni nervoz me partnerin, do të arrini të toleroni në një problem të përbashkët. Gjërat nuk janë më si më parë mes ju të dyve.</p>	 <p>BRICJAPI Sot do t'i përkushtoheni mbrëmjes sepse një takim i rëndësishëm mund të vendosë fatet e jetës suaj.</p>	 <p>UJORI Këtë periudhë favorizohen flirtet e reja, por ndërkohë po kaloni një zhgënjim që do t'ju lerë gjurmë për pak kohë.</p>	 <p>PESHQIT Ndiheni mjaft vitale këtë periudhë dhe po angazhoheni në mirëqenien tuaj fizike. Do të keni përfitime materiale në një projekt të caktuar.</p>

Tayna ruan vendin e parë



Tayna nuk është mposhtur edhe këtë javë. Projekti i saj më i ri muzikor, "Doruntina", vazhdon të mbetet në krye të klasifikimit të 100 këngëve më të bukura të muzikës moderne shqiptare, për të dytën javë rresht. Ajo është shndër-

ruar në reperen më të përfolur, edhe pse ka vetëm pak kohë që ka dalë në tregun muzikor shqiptar. Tayna, emri i vërtetë i së cilës është Doruntina, është pjesë e listës zyrtare të "Top Awards" edhe me tri projekte të tjera muzikore.

Demi Rose shkëlqen në setin e ri fotografik



Ajo është emëruar ambasadore e "Sharleen Collins Cosmetics" dhe Demi Rose nuk mund të zhgënjëjë. Në setin e parë fotografik, Demi ka arritur ta tërheqë vëmendjen,

duke i mahnitur të gjithë me pozat e realizuara. Modeluesja 23-vjeçare tregoi fizikun e mirë teksa prezantonte koleksionin luksoz të produkteve kozmetike.



Merr fund fejesa e Ariana Grandes me Pete Davidsonin

Romanca e këngëtares Ariana Grande dhe komedianit Pete Davidson ka mbaruar. Fejesa e papritur e çiftit i surprizoi të gjithë. Por, një burim i afërt me këngëtares ka thënë për "CNN" se ata i dhanë fund fejesës. Javën e kaluar komedi-

ani mbuloi një nga tatuazhet e tij në qafë dedikuar 25-vjeçares. Davidsoni konfirmoi fejesën e tyre në qershor dhe kishin vetëm disa javë lidhje në atë kohë. Çifti u takua kur Grande ishte e ftuar "SNL" në vitin 2014.

Meghan Markle dhe Princ Harry në pritje të fëmijës së parë

Meghan, dukeshja e Sussexit, është në pritje të fëmijës së saj të parë me princin Harry. Lajmi është konfirmuar nga familja mbretërore e Britanisë. Në një deklaratë Pallati Kensington ka njoftuar se foshnja pritet të vijë në jetë në pranverën e vitit 2019. Mbretëresha Elizabeta II do të jetë gjyshja e fëmijës. Lajmi i bukur vjen pesë muaj pasi çifti u martua në një ceremoni në Windsor Castle.



Kur Fitzgerald ende j

Një nga emrat më të njohur të letërsisë amerikane të shekullit XX është padyshim Scott Fitzgerald (1896-1940), autori i romanit të famshëm "Gatsby i madh", apo siç është përkthyer në frëngjisht "Gatsby i mrekullueshëm", një roman i ekranizuar bukur me aktorin Leonardo di Capri dhe një histori ku gjen diçka nga vetë historia personale e këtij autori. Por ashtu si tek Heminguei, Miller, Dos Pasos dhe amerikanë të tjerë të zbarkuar në Paris në vitet '20-'30, koha e tyre parisiane la gjurmë të pashlyeshme në jetën dhe krijimtarinë e tyre, kohë kur ata do të shkruanin një pjesë të mirë të letërsisë së tyre.

Aty hodhën hapat e para si shkrimtarë edhe Heminguei, Miller, Pound, Anderson, etj. Kur djaloshi nga Minnesota, Scott Fitzgerald erdhi në Paris, ai gjeti një komunitet amerikanësh që i ishin larguar puritanizmit amerikan për tu endur në kafenetë e bordelot e Montmartre-s dhe të Montparnasse-it, duke përfaqësuar atë në të cilën ngulte këmbë estetja amerikane Gertrude Stein "Gjenerata e humbur". Kur mbërriti në Paris me gruan e tij të re dhe një vajzë të vogël, Fitzgerald u vendos në 14, Rue de Tilsitt, një apartament fare afër Harkut të Triumfit.

Në fillimin e viteve '90 kisha shkuar shumë herë në ambasadën belge që ishte në atë rrugë, por atëherë nuk e dija se Fitzgerald kishte banuar disa hapa më tej. Këtë do ta mësoja më vonë.

Pikërisht në Paris Fitzgerald do të merrte vesh botimin e romanit të tij në Amerikë "Gatsby i mrekullueshëm", i botuar në 75.000 kopje, por që shumica e ekzemplarëve nuk u shit dhe vite më vonë shtëpia e botimit u detyrua ta tërheqë nga libraritë. Gjatë

Luftës së Dytë Botërore "Gatsby" u harrua dhe vetëm një ribotim i viteve '50 do ta nxirrte atë në skenën e kritikës letrare amerikane e botërore.

Por Fitzgeraldi kishte kohë që kishte vdekur, që më 1940, në një moshë të re, 44 vjeçare. Pikërisht atëherë biografët filluan të interesohen për të dhe jetën e tij. E padyshim, epoka parisiane ishte nga më të habitshmet, plot legjenda, skandale alkolike, por jo vetëm ai, pasi gruaja e tij Zelda ishte një person depresiv që shkrimtarit të ri i krijonte veç probleme, ndërkohë që ai kishte një etje të jashtëzakonshme për të shkruar, pasi shkrimi për të ishte i identifikuar me paranë, fitimin, ekzistencën.

Si tek Gatsby, edhe atij i pëlqente shoqëria e lartë edhe pse vetë ai vinte nga një familje modeste, por përmes studimesh në një shkollë me të pasur, ku ai kishte mundur të ngjiste shkallë drejt shoqërisë së lartë. Kishte qene gjithnjë ai djali i varfër mes të pasurve... E padyshim, joshja ndaj parasë ishte e madhe. Megjithatë, ai kishte dhe një vështrim kritik ndaj kësaj lloji shoqërie që shkonte deri në ekstreme dhe krime, duke e shkatërruar shpirtin njerëzor.

Siç do të shkruajë dhe Zelda për Fitzgerald pas vdekjes së tij, "ajo çka tregon jeta e tij është se ai diti ta dramatizojë trishtin dhe zhgënjimin e një epoke, duke arritur që me kurajon që i dha kësaj epoke, ai i dha njëkohësisht dhe arësyen që ajo të përjetohej..."

Ardhja e Fitzgerald në Francë nis me një histori dramatike, pasi ata shkuan fillimthi në jug të Francës, në qytezat me diellin e Côte d'Azur, ku Zelda, vajza nga Alabama ra menjëherë në dashuri me një pilot francez dhe pas skandalit ajo donte të vriste

veten. Kështu çifti Fitzgerald iu drejtua Parisit, ku u vendosën në vitin 1925.

Ende pa marrë vesh për botimin e romanit "Gatsby i mrekullueshëm" në Amerikë, në ditarin e tij Scott kishte shkruar: "Nëse ky roman do më sjellë para unë do vazhdoj të jetoj me profesionin e romancierit, por nëse jo, atëherë do të kthehem në Amerikë për të punuar skenarë për kinematografinë hollivudiane..."

Amerikani i parë që takoi në Paris është Heminguei, prej të cilit kishte lexuar në revistat amerikane tregime të ndryshme dhe ishte aq i entuziazmuar nga letërsia e tij sa që e çmonte si shkrimtarin më të madh të kohës.

Në Paris, Heminguei u bë një nga miqtë më të afërt të tij.

Ai e adhuronte, edhe pse ndërkohë "Hemi" siç e quanin miqtë, nuk kishte botuar ende një roman, por veçse novela. Ishte ai që e çoi dhe tek libreria amerikane "Shakespeare and Company" e drejtuar nga Sylvia Beach, njëkohësisht botuesja e Joyce, tek e cila filluan të mblidheshin autorë të shumë amerikanë gjer dhe vetë Witmann.

"Një herë në "Closeries de Lilas - kujtonte Hemi, - Fitzgerald më tregonte sesi i shkruante novelat, të cilat në fakt ishin shkruar mirë për revistën "Post" dhe se si pastaj i ndryshonte për t'i bërë tekste të publikueshme në revista të tjera që të fitonte para. Atëherë u skandalizova dhe i thashë se kjo ishte një punë kurvash. Ai më pohoi se vërtetë ishte i detyruar të vepronte në këtë mënyrë dhe të bënte këtë lloj pune, pasi me romanin s'po fitonte para, kurse me to fitonte shumë, që të mund pastaj të punonte për libra të mirë..."

Hemi kujtonte gjithashtu dhe një



rast kur bashkë me Scott kishin shkuar në Lyon për të marë një makinë dhe në kthim, afër Châlon-sur-Saône, ata kishin ndalur në një hotel. Ishin lagur nga një rrebesh i madh dhe Scott ishte shtrirë i trembur se mos kishte marrë plevitin. Ai i thoshte mikut të tij se ndoshta mund të vdiste dhe kishte hall se kush do të kujdesej më pas për Zeldën dhe vajzën e vogël, Scottie. Por Hemi mundohej ta qetësonte, madje dhe ti thoshte se dhe ai kishte për të mbajtur gruan e tij Hadley dhe djalin Bumby. "Megjithatë i thashë se do të kujdesesha që Zeldën që të mos pinte alkoole dhe që vajza të kishte një guvernante".

Kjo histori vazhdoi dhe të nesërmen, dhe Scott ishte në një gjendje paniku, madje nuk pranonte as treguesin e termometrit që gjithçka e tregonte normale në trupin e tij. Në kthim drejt Parisit, Fitzgerald i kishte dhënë një nga kopjet e librit Gatsby i mrekullueshëm. "Kur e mbarova romanin, - kujtonte Heminguei, - kuptova një gjë: se pavarësisht si kishte arritur ta shkruante atë, unë duhej ta ndihmoja si i sëmurë që ishte, pasi isha miku i tij..."

Midis Hemingueit dhe Zeldës kishte një lloj antipatie të fshe-


htë. Ajo nuk e donte figurën mashkullore të Hemingueit, ndoshta pse e krahasonte me atë të Scott. Dhe Hemingueit i dukej se ishte pikërisht ajo që e shtynte të shoqin të pinte. Mos vallë nuk donte që ai të ishte i famshëm, kurse ajo, e cila kishte lënë baletin prej gjashtë vjetësh, kishte mbetur një grua e zakonshme, që vetëm bridhte nga një lokal në tjetrin? Megjithatë Hemingueit nuk i pëlqente që Scott të ishte kaq shumë i dhënë pas parasë.

Në fakt Scott ishte shumë bujar. Kur pinte e hidhte paranë si të ishte një milioner. Një portieri në një restorant i dha 500 franga që thjesht ti thërriste një taksì, ndërsa orkestrës, i kishte dhënë një mijë franga që ti binin një pjese që i pëlqente atij... Në atë kohë, Fitzgerald dhe Heminguei shkonin shpesh në shtëpinë e Gertrude Stein që banonte në 27, Rue Fleurus. Ishte Heminguei që e kishte prezantuar tek ajo.

Estetja amerikane që jetonte në ato mure mbushur me tablotë e Matisse, Picasso, Cezanne, Renoir, El Greco, etj, e çmonte shumë Heminguein, por kur lexoi romanin e Fitzgerald, filloi të bënte krahasime me atë çka shkruante Heminguei. Dhe kjo Hemingueit nuk i pëlqente pasi



në rrugët e Parisit



ajo e vinte mbi të. Sidoqoftë dy miqtë shkrimtarë e vlerësonin njëri-tjetrin. Kur Heminguei botoi "Lamtumirë armë", kjo gjë e gëzoi shumë Fitzgeraldin, edhe pse Zelda veçse e shante mikun e tij të ngushtë. Por ai e ndaloj që ta shante.

Ndërkohë Fitzgerald filloi të shkruante një roman të ri, duke iu kthyer ngjarjeve të Luftës së Parë Botërore dhe veçanërisht betejës së Marnës. Disa vjet më vonë ai botoi "E ëmbël është nata", një roman që u prit shumë mirë nga kritika amerikane dhe shkrimtarët francezë.

Por në Paris, Scott dhe Zelda u bënë të njohur për skandalet e tyre me njëri-tjetrin. Jeta e tyre ishte me përplasje, dramatike, tragjike. Njëherë, kur Heminguei ishte operuar në spitalin amerikan në Neuilly, i trembur Fitzgerald e kishte pyetur nëse kishte frikë nga vdekja. "Varet nga momenti, - i ishte përgjigjur me të qeshur Heminguei, i cili e dinte se Fitzgerald bënte nganjëherë si fëmijë. Një herë tjetër, siç kujtonte Heminguei, bashkë me gruan i kishin ftuar në apartamentin e tyre në "Rue Tilsitt". Por atë natë Zelda u rrinte gjithë turinj dhe nuk e hapi gojën. Një mbrëmje më parë kishin

qenë të dy në një klub në Montmartre. Zelda i kishte kërkuar të pinte që të ishin në qef të dy por Scott i thoshte se s'donte të pinte se kishte shumë për të shkruar dhe se duhej të punonte. Por Zelda donte qefet e veta dhe i bënte skandale. E megjithatë ai e donte shumë dhe ky trisht i përhershëm e shtynte të pinte shumë, veçanërisht në mbrëmje. Hynte në një lokal dhe dilte tek tjetri.

Shpesh, në mes të natës, Fitzgerald shfaqej në portën e shtëpisë së Hemingueit dhe e kërkonte që ta kalonin natën bashkë, nëpër lokalet parisiane. Por kjo u përsërit shumë herë, aq sa për Hemin u bë diçka e bezdisëshme. Atij i vinte keq për të.

Në librin e tij "Parisi një festë e pambarimtë", Hemingway kujtonte një nga ditët kur Fitzgerald i kërkoi të takoheshin sa më shpejtë sepse kishte diçka të rëndësishme për të biseduar. Dhe ata u takuan në restorantin "Michaud", në Rue de Saintes-Pères, ngjitur me Saint-Germain-dès-Près.

Pasi pinë pak verë, Fitzgerald i hapi zemrën mikut të tij: "- Ti e di që unë s'kam shkruar me asnjë femër tjetër përveç Zeldës. - Jo, nuk e dija. - Kujtoja se ta kisha thënë! - Më ke thënë gjëra të tjera por jo këtë. Pa hë?! - Zelda më ka thënë se nisur nga anatomia e trupit tim, unë s'mund të bëj dot të lumtur një femër tjetër. Eshtë çështja e madhësisë.

Që kur ajo ma tha këtë unë nuk e kam dashur veten dhe dua të di nëse është kështu apo jo? - Shkojmë në banjo atëherë! - i thashë. - dhe ne shkuam dhe u kthyem përsëri në tavolinë. - Ti je plotësisht normal. S'ke asgjë që nuk është në rregull. Po ta shikosh nga lart atë "mikun" e shikon të vogël. Shko në muzeun e Louvre dhe shikoi statujat, pastaj shko në shtëpi dhe shikoje atë në profil me një pasqyrë. - Po përse atëherë ajo ma ka thënë këtë? - Që të mos shkoj mendja të shkosh me ndonjë femër tjetër. Po ti ndërkohë mund të ishte konsultuar një mjek. - Jo, nuk kam dashur. Doja që ti të më thoje të vërtetën. - Po tani a më beson? - Nuk e di. - Atëherë eja të shkojmë në Louvre..." Dhe siç tregon Heminguei, ata shkuan në muze. Fitzgerald shikonte statujat dhe përsëri kishte dyshime. "- Në fakt nuk është çështje madhësie kur ai është në qetësi, - kishte shtuar Heminguei. - Eshtë dhe puna e këndit, - dhe unë i tregova si të përdorte ndonjë jastëk dhe truke të tjera..."

Në vitin 1927, Scott bashkë me Zeldën dhe vajzën e tyre Scottie, u nisën në Amerikë, por gjendja atje i trishti shumë. Jeta ishte bërë shumë e vështirë. Në një intervistë me një gazetar amerikan, Scott ishte shprehur se

"Ajka e Amerikës shkon drejt Parisit. Eshtë diçka e zgjuar për një njeri inteligjent të jetojë në një vend inteligjent. Franca ka dy gjëra që na duhen: inteligjencën dhe sjelljen e mirë". Por shpejt ata do të nisen përsëri drejt Parisit, apo në Côte d'Azur.

Zelda vazhdonte të ushtrohej për baletin. Ajo tashmë ishte 28 vjeçare. Nga ana e tij Scott vazhdonte të punonte për një roman të ri. "Mbrëmë isha i entuziazmuar nga takimi me James Joyce që na ardhni për darkë në shtëpi..." - shkruante në ditarin e tij Fitzgerald. Me këtë rast Joyce i kishte dhuruar një kopje të botimit të romanit të tij "Ulyse" (Uliksi). Por Zelda nuk e donte as irlandezin Joyce... Zelda donte vetëm Scott-in dhe mundësisht të dehur.

Padyshim që jeta e Fitzgerald në Paris ishte një lloj deliri, punë dhe pije, kohë kur banonte në Rue Vaugirard, kur dilte në dritare dhe

pëlqente shumë xhazi, i cili po i tërhiqte gjithnjë e më shumë francezët e "La Belle Epoque".

Një mesnatë, i pirë, kishte shkruar në redaksinë e "Paris-Tribune" ku ishin gazetarët amerikanë, ishte ulur në tavolinë, kishte grisur kopjen e shkrimit të tij dhe pastaj kishte hipur mbi tavolinë, duke kërkuar që të gjithë të këndonin me të. Më së fundi, gazetarët e kishin marrë dhe me forcë e kishin çuar deri në shtëpinë e tij. Po ata asnjëherë nuk ia vunë re sjelljen e tij.

Të gjithë e donin të mirin Scott. Por gjithë këtë e rëndonte padyshim gjendja e Zeldës, e cila po kalonte një depresion të gjatë. Miqtë e Scott tregonin se një herë, duke ardhur drejt Parisit me makinë, Zelda kishte marrë makinën dhe donte të përplasej diku. Scott ishte skandalizuar, por Zelda i thoshte se nuk e komandonte dot makinën. Më së fundi ata kishin shpëtuar fatmirësisht nga ajo



i entuziazmuar bërtiste: "Unë jam Volter!", "Unë jam Rousseau!". Njëherë tjetër, ai kishte parë në rrugë dy xhandarë me biçikleta dhe i kishte ndalur ata, duke u kërkuar tu blinte biçikletat.

Xhandarët ishin tërëbuar, pasi kujtuan se ai po tallej me ta. Donin ta arrestonin, por një miku i tij francez, Chamson, u tha se ishte i pirë dhe se Scott ishte një shkrimtar shumë i madh amerikan.

Lokalet e tij të zakonshme ishin në bulevardin Montaparnasse, në "Dôme", "La Coupole", ku përgjithësisht mbledheshin amerikanët e zbankuar në Paris, në "Le Selecte", "Closeries de Lilas", apo në Saint-Germain-dès-Près tek "Lipp" dhe "Les Deux Magots", pa harruar kabaretë e Montmartre-s... Një nga kabaretë ku ai shkonte më shumë ishte "Bricktop's" që mbahej nga një këngëtare zezake, pasi atij i

katastrofë e paralajmëruar.

Zelda nisi të marrë kurse dansi me një profesoreshë ruse, meqë ëndërronte të dilte një ditë në skenë, në një spektakël madhështor. Kjo pamundësi e bënte të vuante nga deliret. Njëherë, në vitin 1929, në kohën e "depresionit ekonomik" dhe të "crash of Wall Street", duke shëtitur, Zelda i thoshte Fitzgeraldit se po dëgjonte lulet që i flisnin. Ata kishin shkruar në tregun e luleve të Parisit, por thëniet e saj ishin një delir i vërtetë.

Në raportin mjekësor të klinikës ku ajo u shtrua, shkruhej se "ajo pëshpërit vazhdimisht: "është e tmerrshme, çdo të bëhet me mua, unë dua të punoj por s'do mundem, duhet të vdes e megjithatë dua të përgatitem për të interpretuar balet... jo, nuk do të shërohem kurrë... Duhet të shoh Jonjën..." E diagnostikuar me

skizofreni, në një klinikë tjetër ai shkroi romanin gjysmë-biografik "Më lejoni ta vallëzojmë këtë dans", ku përshkruan gjithashtu jetën e saj të turbullt parisiane.

Këtë gjendje të nderë e ndjen dhe në letrat që Scott i dërgonte Zeldës, ku në njëherë prej tyre, ai i shkruante: "Në të kaluarën, ti dhe unë kemi njohur ditë të mrekullueshme por e ardhmja do të jetë edhe më e bukur nëse ti nuk do të jesh melankolike e të mos përpiqesh ti shohësh gjërat ndryshe. Asgjë nuk e justifikon trishtimin tek ty. Ne s'kemi qenë të lumtur vetëm një herë, por njëmijë herë. Siç thuhet dhe në këngë, pranvera, si për të gjithë, edhe për ne është një shans i shkëlqyer e unë në këto çaste e kam në dorë pothuaj gjithë opinion letrar bashkëkohor dhe ndërkohë shoh të notoj një mjellmë që më duket se je vetë ti. Ah, Mjellma ime, noto ngadalë, sepse ti je mjellmë, sepse përmes linjës së mrekullueshme të qafës tënde perënditë të kanë bërë një favor të veçantë që edhe pse e ke krisur duke u goditur në një urë të vogël, plaga të është shëruar dhe ti vazhdon rrugën tënde.

Harroje të kaluarën aq sa mund të harrosh dhe kthehu e eja drejt meje, drejt kësaj strehe paqeje që është tëndja përgjithnjë, edhe pse ndonjëherë mund të të ngajë me një guvë të errët të ndriçuar nga ura zjarri të hazdisura; është streha më e mirë për ty. Kthehu ngadalë në ato dallgë ku po noton dhe eja. Kjo ngjan me një lloj alegorie, por në fakt është reale.

Dua që ti të jesh kështu. Trishtimi i së kaluarës nuk më ndahet asnjëherë. Gjërat që kemi bërë sëbashku, zënkat e së kaluarës n'a kanë kthyer në njerëz të thyer, por që i kemi mbijetuar kësaj lufte, e cila tashmë ka mbetur si një atmosferë përreth çdo shtëpie ku unë jetoj..."

Pas një qëndrimi pothuaj një vjeçar në shtëpinë e tyre në Rue Pergolese, pranë "Bois de Boulogne", çifti Fitzgerald u largua nga Parisi, dhe padyshim, vitet parisiane do të ishin për Fitzgerald vite nostalgjie dhe një lëngim i trishtë e i gjatë... Në Paris ka një restorant lluksoz me emrin "Fitzgerald" në avenue La Tour Maubourg, në kujtim të autorit amerikan. Dikur kam banuar dy hapa pranë tij dhe asnjëherë s'isha hyrë atje, por ky shkrim më bëri të shkoj ta shoh.

Eshtë pjesë e atij itinerari parisian të jetës së Fitzgerald, nga "Hôtel St. James" në Rue Saint-Honoré apo "Hôtel des Deux Mondes" në avenue de l'Opera e pastaj në Rue Tilsitt, Rue Vaugirard apo Rue Pergolese gjer në largimin e tij nga Parisi më 1931... Kudo ruhet me nostalgji kujtimi i këtij shkrimtari që iku tepër i ri nga kjo botë.

(Luan Rama / gazeta-Shqip.com)

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

FRANCE - GERMANY

3+

UKRAINE - CZECH REPUBLIC

3+

KAZAKHSTAN - ANDORRA

1&3+

U21-shat duan t'i mbyllin kualifikimet me fitore

U21-shat e Kosovës sot e zhvillojnë ndeshjen e fundit në grupin 5 kualifikues për Evropianin 2019 ndaj Izraelit. "Jemi maksimalisht të gatshëm për lojë. Të gjithë presim fitore, të gjithë së bashku duam ta marrim rezultatin e duhur pas asaj humbjeje të pamerituar në Mitrovicë. Në radhë të parë duam ta japim maksimumin për fanellën e Kosovës, derisa në radhë të dytë duam t'u hakmerremi izraelitëve për atë humbje në Mitrovicë", ka thënë Florent Hasani

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 15 TETOR - Trajneri i Përfaqësueses së Kosovës U21 në futboll, Rafet Prekazi, ka bërë me dije se në ndeshjen ndaj Izraelit do t'u japë rastin edhe lojtarëve të rinj, pasi është koha e ndryshimit të gjeneratave të futbollistëve dhe se është duke menduar për ciklin e ardhshëm kualifikues.

Kosova sot (e martë) e zhvillon ndeshjen e fundit për kualifikueset e Evropianit 2019. "Besoj se do të kemi paraqitje të mirë sikurse deri më tash. Mund të kemi një problem kushtimisht të vogël sepse do ta bëjmë ndërrimin e gjeneratës, sepse është loja e fundit për lojtarët e lindur në vitin 1996. Për këtë arsye edhe kësaj radhe kam ftuar 7-8 futbollistë që janë të vitit 1998 ngaqë dua ta krijojë ekipin për ciklin e ardhshëm kualifikues. Prandaj, duhet t'u jepet rasti edhe lojtarëve të rinj dhe ky është qëllimi ynë për ndeshjen kundër Izraelit", ka thënë Prekazi.

Për ndeshjen ndaj Izraelit foli edhe sulmuesi i Kosovës, Florent Hasani, i cili është ndër më të mirët tek U21-shat. Ish-sulmuesi i Vushtrisë, Trepçës '89 dhe tash i Diosgyorit, ka thënë se të gjithë presin fitoren në këtë ndeshje. "Jemi maksimalisht të gatshëm për



lojë. Të gjithë presim fitore, të gjithë së bashku duam të marrim rezultatin e duhur pas asaj humbjeje të pamerituar në Mitrovicë. Në radhë të parë duam ta japim maksimumin për fanellën e Kosovës, derisa në radhë të dytë duam që t'u hakmerremi izraelitëve për atë humbje në Mitrovicë", ka thënë Hasani.

Në linjë të njëjtë me sulmuesin Hasani është edhe Arbër Hoxha, i cili kërkon hakmarrje për humbjen e parë që izraelitët i kishin shkakuar Kosovës në Mitrovicë. "Atmosfera në ekip është e shkëlqyeshme dhe, po ashtu, edhe stërvitjet po ecin mirë. Të gjithë futbollistët po punojnë me seriozitet të madh dhe po e presin duelin me Izraelin. Synimi është

t'u hakmerremi izraelitëve për atë humbje të pamerituar në Mitrovicë", ka deklaruar Hoxha. Kosova aktualisht pozicionohet në vendin e katërt në grup me 12 pikë të grumbulluara.

GRUPI 5		
17:00	Izrael U21 - Kosova U21	
18:15	Gjermania U21 - Irlanda U21	
18:15	Norvegjia U21 - Azerbajxhani U21	
TABELA		
		PIKË
1.	Gjermania U21	9 22
2.	Norvegjia U21	9 14
3.	Irlanda U21	9 14
4.	Kosova U21	9 12
5.	Izraeli U21	9 11
6.	Azerbajxhani U21	9 2

Sot zhvillohen dy ndeshje në Superligë

PRISHTINË, 15 TETOR - Pas ndeshjeve të Kombëtareve në Ligën e Kombeve, rikthehen ndeshjet në kampionate. Sot (e martë) në kuadër të IPKO Superligës së Kosovës në futboll zhvillohen dy ndeshje nga ora 14:45. Në Prizren Liria e pret skuadrën e Trepçës '89, kurse në kryeqytet takohen Flamurtari dhe Drenica. Dy ndeshje të tjera të kësaj xhiroje zhvillohen të mërkurën: Drita - Ballkani dhe Llapi - Gjilani. Ndërsa Komisioni i Garave i IPKO Superligës me kërkesë të klubeve



ka vendosur që dy ndeshjet e javës së 9: Feronikeli - Prishtina dhe KEK-u - Ferizaj të shtyhen për 7

nëntor për shkak të angazhimit të lojtarëve të këtyre klubeve me ekipet përfaqësuese.

SHKURT

Të mërkurën Prishtina fillon rrugëtimin në Fiba Europe Cup

Klubi i Basketbollit Z Mobile Prishtina të mërkurën do ta fillojë rrugëtimin për në Fiba Europe Cup, ku do të ndeshet me ekipin ukrainas Cherkaski Mavpy. Atmosfera pritet të jetë e zjarrtë e krijuar nga "Plisat" dhe kërkesat e shumta të tifozëve për ta parë nga afër këtë ndeshje që do të zhvillohet nga ora 20:00 ditën e mërkurë. Prishtina është ndër klubet e pakta ballkanike që po merr pjesë në këtë garë mjaft të fortë evropiane dhe ajo është radhitur e dyta në grup, duke pasur parasysh arritjet në vitet e fundit në arenën evropiane. Të mërkurën e gjithë vëmendja do të jetë në Prishtinë, pasi interesimi është i jashtëzakonshëm.

Goli i parë për Kosovën, flet Milot Rashica

Ylli i Werder Bremenit në Gjermani, Milot Rashica, në ndeshjen ndaj Ishujve Faroe e ka shënuar golin e parë në fanellën e Kosovës. "Jam i lumtur që më në fund erdhi goli në fanellën e Përfaqësueses së Kosovës në futboll, por do të isha më i lumtur nëse do të kishim fituar. Këtë gol ia dedikoj familjes dhe tifozëve, por edhe ish-presidentit Fadil Vokrri. Pjesën e parë e filluam mirë, por jo të dytën. Kemi pasur disa raste, por edhe Ishujt kanë bërë paraqitje të mirë. Edhe fusha ka qenë në gjendje të keqe. Madje edhe pasimet më të thjeshta ishin të vështira", ka thënë Rashica.

Usain Bolt drejt kampionatit italian?

Usain Bolt e ka nisur mjaft mirë aventurën si futbollist te skuadra australiane e Central Coast Marines, ku ka shënuar edhe dy gola në një miqësore me këtë skuadër. Ëndrra e vërtetë e atletit xhamajkan është që të luajë për një skuadër të madhe evropiane dhe nuk ka ndërmend të heqë dorë pa e realizuar. Së fundi, menaxheri i Bolt, Tony Raills, deklaroi se për xhamajkanin ka pasur oferta nga një klub evropian, që prej pak kohësh drejtohet nga një pronar i ri dhe që synon të rikthehet të luajë në Ligën e Kampionëve. Përshkrimi që ka bërë menaxheri i Boltit, shumë media i ka çuar pikërisht te Milani, që mund të sjellë që në janar atletin dhe tashmë futbollistin xhamajkan, Usain Bolt, në Milano, për të pasur një alternativë të mirë në krahët e sulmit. Për më tepër, mendohet se Fondi "Elliot" mund ta përdorë atletin kampion bote nga Xhamajka, jo vetëm si një alternativë për trajnerin Gattuso, por edhe si një njeri imazh, për të afruar sa më shumë sponsorë në skuadër.

Shaqiri: E dija se do ta kem më të vështirë në Liverpool

Mesfushori me origjinë shqiptare i Liverpoolit, Xherdan Shaqiri, ka thënë se ai e dinte se do ta kishte më të vështirë ta dëshmonte veten në një skuadër të nivelit të Liverpoolit në krahasim me ish-klubin e tij, Stoke City. "Ata nuk kanë nevojë të më mbajnë mua të lumtur. Ky proces ka shkuar mirë deri tani për mua. Natyrisht, çdo profesionist dëshiron të luajë sa më shumë, por ka ende shumë ndeshje në këtë sezon", ka thënë Shaqiri. "Përpos kësaj, ne duhet ta shikojmë dhe ta vlerësojmë atë që ka arritur ta bëjë deri më tani Liverpooli. Shumë futbollistë kanë bërë punë shumë të mirë. Për këtë arsye, skuadra nuk është ndryshuar plotësisht brenda natës. Ajo që po ndodh në Liverpool është pikërisht ajo që prisja të ndodhte. Unë vendosa të transferohesha në Liverpoolin, i vetëdijshëm se do të kishte më të vështirë në një klub të këtij niveli sesa në disa klube të tjera, të cilët më bënin oferta", ka deklaruar Shaqiri.

Greza dhe Balaj: Nuk e merituan humbjen

TIRANË, 15 TETOR - Pas humbjes nga Izraeli (2-0), lojtari i Kombëtares së Shqipërisë, Eros Grezda, ka thënë se kuqezinjët nuk e merituan humbjen në këtë ndeshje. "Është ndjenjë e keqe sepse nuk meritonim të kumbisnim.

Kishim shumë raste dhe nuk i shfrytëzuam. Në pjesën e dytë bëmë ndeshje tjetër pasi Izraeli e kuptoi pak lojën tonë. Megjithatë, duhet të shënonim. Është e vështirë, normalisht. Nuk jam në formën time më të mirë. Luajta 90 min-

utëshin e parë pas 6-7 muajsh. Ishte e vështirë për mua të gjeja hapësira sepse më dublonin", ka shtuar Grezda. Ashtu sikurse Grezda, edhe Bekim Balaj ka thënë se Shqipëria nuk është dashur ta humbasë ndeshjen ndaj

Izraelit në Ligën e Kombeve. "Luajtëm mirë, e kishim përgatitur mirë, dhe të vjen keq që humbim 2-0. Minimumi do të ishte një barazim i drejtë. Krijua shumë raste, por në futboll ndodh", ka deklaruar Balaj.



Karateistët e Kosovës, paraqitje pozitive në Premierë Ligën e Japonisë

PRISHTINË, 15 TETOR - Përfaqësuesja e Kosovës në Karate mori pjesë në Premierë Ligën "Tokyo Premiere League 2018" që u mbajt në Japoni. Adelina Rama u rendit e 9-ta, në një konkurrencë shumë të fortë. Adelina Rama kishte një paraqitje shumë të mirë në "Tokyo Premiere League 2018". Ajo mori pjesë në kategorinë deri në 61 kilogramë, ku fitoi nga garuesja e Indonezisë, Azerbajxhanit, humbi nga garuesja e Francës, kurse në repasazh për vendin e tretë humbi nga garuesja e Kroacisë. Adelina Rama u rendit e 9-ta, në një konkurrencë shumë të fortë, ku kjo paraqitje është e vlefshme për normën Olimpikë. Kurse Fortesa Orana u paraqit në kategorinë mbi 68 kilogramë humbi nga garuesja e Japonisë. Orges Arifi, në kategorinë deri në 61 kilogramë, humbi nga garuesi i Sllovakisë. Alvin Karaqi deri në



84 kilogramë fitoi nga ai i Kanadasë, Spanjës, kurse humbi nga ai i Kazakistanit. Në "Tokyo Premiere League 2018" nga FKK-ja, drejtësinë e ndau edhe Ardian Muhadri, gjyqtarë me licencë botërore. Pjesë e ekspeditës ishin

edhe kryetari i Federatës së Karatesë, Ismet Krasniqi, përzgjedhësi i përfaqësueses së Kosovës, Isak Curri, që u ndanë të kënaqur me paraqitjen e garuesve të Përfaqësueses së Kosovës në Karate.

Modriqi: Do të kisha dashur të isha shok skuadre me Zidanen

PARIS, 15 TETOR - "France Football" do të publikojë sot (e martë) një intervistë me Luka Modriqin, i cili kohët e fundit fitoi çmimin "The Best" të FIFA-s. Kroati është edhe favorit për ta fituar "Topin e Artë" për vitin 2018. Në deklaratat që revista e njohur sportive franceze ka paraqitur në kopertinën e saj, lojtari kroat bën një vlerësim të ish-trajnerit të tij, Zinedine Zidane, me të cilin ka fituar tri Liga të Kampionëve, e fundit të Real Madridi: "Mua do të më pëlqente të isha një shok skuadre i Zidanës, të luaja në krahë të tij".

Mesfushori nënkampion bote imagjionon me këtë stilin dhe cilësinë në raport me topin, sepse të dy kanë treguar një ide të ngjashme të të luajturit futboll: "Futbolli është një lojë që luhet me kokë". Një tjetër nga frazat e Modriqit, që revista përparon ta bëjë publike, ka të bëjë



me Cristiano Ronaldo, shokun e tij të skuadrës të Real Madridi deri këtë verë, me të cilin ka arritur suksese të mëdha: "Cristiano qëndron shumë lart. Është më i miri prej të gjithëve...". Kjo revistë sportive

bën me dije edhe mendimin e Modriqit për yllin në rritje të futbollit francez, Kylian Mbappe, me një Kupë Bote në xhepin e tij, tashmë: "Unë jam i sigurt se Mbappe do të vazhdojë të përparojë".

SHKURT

Ndërroi jetë sekretari i përgjithshëm i FIBA-s, Patrick Baumann

Sekretari i Përgjithshëm i Federatës Ndërkombëtare të Basketbollit (FIBA), Patrick Baumann, ka ndërruar dje jetë në moshën 51-vjeçare. Në deklaratën e publikuar nga FIBA, thuhet se Baumann, i cili gjendej në kryeqytetin e Argjentinës, Buenos Aires, për Lojërat Olimpikë për të Rinj 2018, ka ndërruar jetë si pasojë e sulmit në zemër. Baumann, i cili është në mesin e anëtarëve të Komitetit Olimpik Ndërkombëtar (IOC), që nga viti 2002 ishte në detyrë si sekretar i përgjithshëm i FIBA-s.

Federeri: Do të luaj edhe në vitin e ardhshëm

Roger Federeri, pas eliminimit në gjysmëfinalen e turneut Masters të Shangait, ka humbur vendin e dytë të renditjes botërore, duke ia lëshuar atë Novak Djokoviqit, fitues në Kinë. Por tenisti zviceran nuk ka humbur dëshirën për të vazhduar të luajë sportin e tij të zemrës dhe pas rikthimit në vendlindje, ai ka deklaruar se do të vazhdojë të zbrësë në fushë edhe gjatë vitit 2019. "Një gjë është e sigurt, do të jem në fushë edhe në sezonin tjetër. Unë ende nuk kam një plan të detajuar për 2019-ën, por shpresoj të luaj sa më shumë të jetë e mundur. Në dilemë jam për turnetë në fushat me dhë. E rëndësishme është të jem mirë fizikisht dhe të luaj mirë në çdo ndeshje, për ta arritur objektivin, fitoren", ka deklaruar Federeri, që përgatitet për turnetë evropiane.

Matthausi preferon Ter Stegenin para Neuerit

Ish-lojtari i Kombëtares së Gjermanisë, Lothar Matthaus, e ka këshilluar trajnerin Joachim Low për ndryshime në portën e kombëtares gjermane. "Marc-Andre Ter Stegen ka vite që luan në nivelet më të larta të Barcelonës dhe mendoj se e ka merituar shansin të luajë ndeshje të rëndësishme nga minuta e parë, edhe nëse Neueri është në dispozicion", ka thënë Matthaus. "Manuel Neueri nuk është aktualisht në formë dhe nuk ofron sigurinë që jepte para dëmtimit serioz. Nuk është kthyer ende në nivelin optimal dhe nuk mund të thuhet që është ndër portierët më të mirë në botë në këtë kohë", ka shtuar Matthaus.

Napoli dhe Roma në garë për Piatekun

Krzysztof Piatek është një nga sulmuesit më në formë në Evropë dhe golat e shënuar me Genoan kanë tërhequr vëmendjen e shumë klubeve italiane. Napoli është një nga klubet kryesore që po monitoron polakun, por në garë është futuri edhe Roma. Siç raporton "Corriere dello Sport", Monçi, drejtori sportiv i verdhekuqve, ka arritur akordin me menaxherin e 23-vjeçarit. Nga ana tjetër, Napoli ka ofruar 35 milionë euro për kartonin e tij dhe dëshiron ta mbyllë tratativën që në janar. Për Piatek interesohet edhe klubi i Juventusit, Barcelonës, Atletico Madridit dhe Borussia Dortmundit.

Unitedi nuk ia rinovon kontratën, Valencia në kërkim të ekipit të ri

Te Manchester United janë shumë lojtarë në vitin e fundit të kontratës dhe një prej tyre është edhe kapiteni Antonio Valencia. E ardhmja e 33-vjeçarit është e qartë, larg "Old Trafford", duke parë se drejtuesit nuk do t'i rinovojnë kontratën, por edhe për faktin se nuk shihet më si titullar nga Mourinho. Edhe afrimi i mundshëm i një trajneri tjetër nuk do të ndryshonte situatën rreth Valencias për shkak të moshës, çka e ka shtyrë lojtarin t'i nisë kërkimet për një ekip tjetër. Që më 1 janar të 2019 Valencia është e lirë ta zgjedhë ekipin e ardhshëm.



Autor: GAZMEND MORINA						PERDE LËVIZËSE QË SHËRMBEN PËR TË NDARË NJË LOKAL (shq.)	NGJALLJA E KUJTIMEVE PËR DIKË A DIÇKA	POLITIKANI ITALIAN PRODI	ARMATA REPUBLIKANE IRLANDEZE (sh. orgj.)	VRANËSIRË	ZANORE	KUFIRI	I DJEGUR NË FLAKË	EPOKA E RE	BIMË SHUMËVJEÇARE ME TRUNG TË TRASHË	AKTORI MORINA	
PENGESË A VËSHTRËSI E PAPRITUR														DRIËTËRO AGOLLI NJËSIA E REZISTENCËS ELEKTRIKE			
AVULL QË DEL NGA TOKA											BASHKIM I HARMONISH-ËM I DISA TINGUJVE SMALT						
KRYEQYTETI I NJË SHTETI TË MADH EVROPIAN										PASANIKE GJENDJE KU MUNGON PUSHTETI I ORGANIZUAR SHTETËTOR							
"K" në mes të dy "A"									MUNGESË GJALLËRIE, ZHVILLIMI E PËRPARIMI VITRINA, RAFTI						ZANORE DJALË OSE VAJZË DERI TETË A NËNTË VJEÇ		
AKTORJA AMERIKANE RYDER (shqip.)												ZANORE		DEM UGANDA, TANZANIA			
QË I MUNGOJNË PARIMET MORALE												MBRON DIKË NGA DIKUSH VEPRAT E KRIMINELËVE					
NAIM ISMAJLI								DY BASHKË- TINGËLLORE KËNGËTARJA E FAMSHME ... KIM			KRUJA BASKETBOLL- ISTI TURK ONAN		DY BASHKË- TINGËLLORE THIRRJA E MYEZINIT			XEHETAR	
AKTORJA AMERIKANE NË FOTO (shqip.)						SHPËRTHYES, GUFUES	RITUAL	I PLOGËT	THIKA QË MBAHEJ SI ARMË BREZI (vjet.)	ZANORE OTRANTO	VIJË E PËRKULUR SI LAK BANORI I KRYEQYTETIT TË FILIPINEVE				AZEM MAKSUTAJ ZANORE		
ROK BEND I YNI											ZVOGËLIMI I TEPËRT MBATHËSE SPORTIVE						
NEVOJË FIZIOLOGJIKE											REGJISORI SHQIPTAR KUKË		SOLISTJA ... QAZIMI SHKRIRË		ALEN NURI IRNOSE (bised.)		
I FALEM A I DREJTOJ LUTJE NJË HYJNIE OSE NJË SHENJTI									ALESANDRO NESTA AKTORI AMERIKAN ADAM (shqip.)	JOMETAL QË PARAQITET SI PLUHUR ME NGJYRË HIRI	MJET UDHËTIMI A TRANSPORTI (shq.) UDINESE				ZANORE QË ËSHTË ME TINGUJ TË ÇRREGULLUAR		
ISMET PEJA							QËLLUAR RASTËSISHT NË NJË NGJARJE I KËPUTUR; I MPAKUR						TINARËT LLOJ REVOLEJE				
BABAIT									SHTET NË AMERIKËN JUGORE BASHKËT.			ELIZABETH BANKS ZANORE	E ZATETE, E	FUTBOLLISTI SAMUEL ... I BËRA GATI			
SHTEG, RRUGË E NGUSHTË								NDARJE E VOGËL ADMINISTRATIVE (shq.) AKTORJA AM. PORTMAN (shqip.)							MOR, HEJ (pasth.) ZANORE		
FUTBOLLISTI ANGLEZ MAJKËLL									GOTA PREJ METALI SHPEND SHTËPIAK			STUHI E FORTË ME SHI				KLUB I YNI FUTBOLLI	
BASHKËT.						ZË ME DORË SHAKAJA				ZANORE	INTENSITET, KARBON GRUMBULL KOKRRIZASH TË IMËTA (shq.)				SHKRONJAT E PARA SULMIM		
E SHASTISUR									KRYEQYTETI I URUGUAIT VIDEO	ZANORE ZONË E PËRHAPJES SË NJË GRUPI KAFSHËSH A BIMËSH			TËRËSORE, E PËRGJITHSHME				
QË KA TË BËJË ME FSHATARËSINË									NËNAT KLUBI I BASKETBOLLIT PRISHTINA				AFROJ (bised.) TORINO, ATALANTA			BASHKËT. TË HOLLA	
DY BASHKË- TINGËLLORE							BYREK ME LAKRA TË GRIRA (sh.shq.) LIGJ (vjet.)						FAZA TEFTA TASHKO				
KËNGËTARJA MALAJ									APARTAMENT BANIMI (sh.shq.) MINUS (Mat.)					AUSTRALIAN KARTING ASSOCIATION ENEDA TARIFA		IGLI TARE	
EPOKA E RE						"RODA" BASHKËT.		SHKRONJA TË NJËJTA ZANORE		TANTAL, INTENSITET BASHKËT.			"TETOVA" BASHKËT.		I MITUR ZANORE		
LËNDË MËSIMORE									PËRSHËNDE- TJE (krah.)							OBJEKTI I BISEDËS (sh.shq.)	

ZGJIDHJA E FJALËKRITIT: PERIPECI, DA, AVORE, AKORD, ROMA, E KANUR, AKA, ANULLI, I VINOVA, U, KA, AMORAL, RUAN, NI, MR, K, TL, I, LAKORE, AM, XHERIKO, MINIMIZIMI, URINA, PALI, EMA, AN, LUTEM, AN, TRENI, A, IP, RASTISUR, TIRAT, ATIT, KILI, EB, ETO, RIM, LOKALITETI, OR, OVEN, TASI, URAGAN, B, KAP, IC, REKA, AB, E HUTUAR, A, TOTALE, RURAL, EMAT, AVIT, S, SONI, BANESAT, AKA, RO, PP, TAJ, TE, I, RI, KIMIA, SELAM, TEMAT.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo
Agency of Statistics

Ne bazë të Kreut III neni 11 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe neni 22 paragrafi 3 të Rregullores Nr. 02/2010 Procedurat e Rekrutimit të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës, Agjencia e Statistikave të Kosovës shpallë:

NJOFTIM

Vazhdohet edhe për shtatë (7) ditë kalendarik afati i konkursit, i shpallur me dt. 28.09.2018 në gazetën ditore Epoka e Re në ueb-faqen e Agjencisë të Statistikave të Kosovës për arsye se nuk është arritur numri i balancuar i aplikacioneve nga aspekti etnik për pozitat:

1. Departamenti i Llogarive Kombëtare një (1) pozitë e karrierës

Titulli: Një (1) Drejtor të Departamentit të Llogarive Kombëtare

Numri i referencës : ASK-DLLK-001

2. Departamenti i Regjistrimit dhe Anketimit, një (1) pozitë te karrierës:

Titulli: Një (1) Zyrtar për statistika në Prizren

Numri i referencës : ASK-DRA-002

Konkursi është i hapur 7 ditë kalendarik nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik.

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Agjencionin e Statistikave të Kosovës, Rr. "Zenel Salihu" nr.4 Prishtinë. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, dëshmi mbi përvojën e punës, vërtetimin nga Gjykata që personi nuk është nën hetime dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për vendin e punës për të cilin konkurren.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni në zyrën e personelit, në tel: 038-20031149, prej orës 08:00 – 16:00.

Na osnovu Poglavlja III, člana 11 Zakona Br. 03/Z-149 o Civilnoj Službi Kosova, i člana 22, tačka 3, Uredbu Br. 02/2010 o Proceduri Regrutiranja u Civilnoj Službi, Agencija za Statistiku Kosova objavljuje:

O B A V E Š T E N J E

Produžen je za sedam (7) kalendarskih dana rok za dostavljanje prijave za konkurs koji je objavljen 28.09.2018 na dnevnu novinu „Epoka e Re“ i na veb-stranici Agencije za Statistiku Kosova jer nije dostignut uravnoteženi broj prijave sa etničkog aspekta za pozicije:

1. Odeljenje Statistika Nacionalnih Računa jedna (1) pozicija od karijere:

Naziv radnog mesta: Jedan (1) Direktor Odeljenja Statistika Nacionalnih Računa

Referentni broj: ASK-OSNR-001

2. Odeljenje Popisa i Anketa, jedna (1) pozicije od karijere

Naziv radnog mesta: Jedan (1) Službenik za Statistiku u Prizrenu

Referentni broj: ASK-OPA-002

Konkurs je otvoren 7 kalendarskih dana od dana objavljivanja u sredstvima javnog informisanja.

Uzimanje i podnošenje prijave:

Prijave se uzimaju i podnesu u Agenciju za Statistiku Kosova, Ul. "Zenel Salihu" br.4, Prishtina. Uz prijave potrebno je priložiti i kopije dokumenata o kvalifikaciji, dokaz stručnog radnog iskustva, potvrdu suda da osoba nije pod istragom i ostalu potrebnu dokumentaciju koja je potrebna za radno mesto za koju se prijavljujete.

Prijave dostavljene posle isteka roka za prijavljivanje neće biti primljene. Nepotpune prijave će biti odbijene.

Za dodatne informacije možete kontaktirati Kadrovsku Kancelariju na broj telefona: : 038-20031149 od 08:00 – 16:00 časova.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Dardania Inxhiniering” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: NRB. Biznesit 810006561 dhe nr.fiskal: 810006561 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë Kooperativë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

O B A V E S T E N J E

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Dardania Inxhiniering” D.O.O. od Pristina, donelo odluku o prestani rada sa bisnisom : NRB. Biznesit: 810006561i broj fiskala: 810006561 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

A N N O U N C E M E N T

All clients are to be informed that the “Dardania Inxhiniering “ L.L.C. in Prishtina, has come to the decision to quit its business: NRB. Biznesit: 810006561, i number fiskal: 810006561 The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



O F E R T Ë P Ë R S H I T J E T Ë S H T Ë P I S Ë

Shitet shtëpia dykatëshe, me sipërfaqe prej 218 m2, dhe trualli me sipërfaqe prej 410 m2.

Shtëpia gjendet në Prishtinë, në lagjen "Aktash I", rr. "Ferhat Draga" nr. 1.

Procedura e transaksionit nga shitësi të blerësi bëhet pas nënshkrimit të kontratës së shitblerjes dhe pagesës së çmimit të kontraktuar, pastaj paluejtshmëria e përshkruar më lart kalon te blerësi.

Çmimi sipas marrëveshjes.

**Informata më të hollësishme
mund të merren në numrin e telefonit
001-347-331-8305 në Nju Jork, kurse në Prishtinë
në celularin 044-166-580.**



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – RÉPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



Nr. 07-180/18
Dt.16.10.2018

KOMUNA JUNIK

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/040, neni 17, në bazë të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 të Republikës së Kosovës nenet 7 dhe 8, Ligjit mbi Arsimin Para universitar të Republikës së Kosovës nr 04/L-032, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it nr 10/2018, për normativ mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ të MPMS - nr 07/2017, për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Komuna e Junikut shpallë:

KONKURS

Për plotësim e vendit të lirë të punës për vitin shkollor 2018/2019

Shkolla fillore e mesme e ulët "Edmond Hoxha" në Junik

Dy (2) mësimdhënës/e për lëndën Gjuhë dhe Letërsi Angleze për 12 orë.

KUSHTET:

- Për vendet e lira të punës për mësimdhënës/e kërkohet përgatitja profesionale përkatëse,
- Në mungesë të kuadrit të kualifikuar vijnë në konsiderim kandidatët me kualifikim të përafërt.

DOKUMENTACIONI I KËRKUAR:

1. Diploma (çertifikata),
2. Çertifikata e lindjes,
3. Letërnjoftimi i fotokopjuar,
4. Dëshmi për përvojën e punës,
5. Dëshmi për trajnimet arsimore,
6. Çertifikata e shtetësisë,
7. Çertifikata nga Gjykata që nuk jeni nën hetime
8. Vërtetim nga Zyra e Punësimit.

Luteni që të dorëzoni vetëm kopjen e vërtetuar/noterizuar të dokumenteve të listuara më lartë. Aplikacioni tërhiqet dhe dorëzohet në Zyrën e pritjes në Junik, dokumentacioni i pakompletuar si dhe ato pas afatit nuk merren në shqyrtim. Afati i konkurimit është 15 ditë nga data e shpalljes në gazetën ditore.

Kandidatët të cilët përzgjidhen në listën e ngushtë për intervistë njoftohen me shkrim ose në telefon në afat ligjor, kandidatët janë të obliguar që të sjellin me vete dokumentet origjinale mbi kualifikimin, trajnimet dhe të gjitha ato dokumente të cilat janë dorëzuar në aplikacion, dhe të cilat duhet të verifikohen nga Komisioni intervistues.

Udhëheqësja e personelit:
Vencra Shala



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – RÉPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



Nr. 07-180/18
Dt.16.10.2018

KOMUNA JUNIK

Bazuar në nenin 8 të Ligjit i Punës Nr. 03/L-212, si dhe në mbështetje të Udhëzimit Administrativ të MPMS - nr 07/2017, për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Komuna e Junikut shpallë:

KONKURS

Për plotësim në vendin e punës:

1. Mjek i përgjithshëm -numri i kërkuar 1 (Një),

Orari i punës i plotë.

Paga: E përcaktuar me buxhetin e Kosovës

Në mungesë të kandidateve me kualifikimin e kërkuar përparësi do të kenë specialistet e mjekësisë familjare apo mjek i mjekësisë së përgjithshme.

Dokumentet e kërkuara për mjek specialist: Çertifikata mbi specializimin e kryer nga dega përkatëse, licenca e punës, çertifikata e lindjes, çertifikata e shtetësisë si dhe dokument identifikimi.

Dokumentet e kërkuara për infermier/e: Diploma mbi kualifikimin në kryer nga dega përkatëse, licenca e punës, çertifikata e lindjes, çertifikata e shtetësisë si dhe dokument identifikimi.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin adekuat dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Procedurat e konkurimit: Konkurimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar. Konkursi mbetet i hapur 10 ditë pas publikimit në mjetet e informimit. Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së konkursit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen. Kandidatët e interesuar mund të marrin aplikacionet për ç' do ditë pune në ndërtesën e komunës së Junikut në Zyrën për shërbim me qytetarë.

Udhëheqësja e personelit:
Vencra Shala

AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë

**Eksperiencia jonë
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave / Ministarstvo Finansija / Ministry of Finance
Thesari i Kosovës/Trezor Kosova/Treasury of Kosovo

Shpallje e Ankandit të Letrave me Vlerë KV018-18

Afati dhe Lloji	2 Vjeçar – Obligacion Qeveritar
Shuma e Ofruar	€20,000,000
Kodi i Instrumentit	KV1213011309
Data e Ankandit	23.10.2018
Data e Shlyerjes	24.10.2018
Data e Maturimit	24.10.2020
Mekanizmi i Çmimit	Çmime të Shumëfishta

Shënim: Qeveria e Republikës së Kosovës rezervon të drejtën për ri-blerje të kësaj ltrave me Vlerë nëpërmjet operacioneve të përcaktuara në Rregulloren për Tregun Primar dhe Sekondar të Letrave me Vlerë të Qeverisë.

Announcement of Securities Auction KV018-18

Term and Type	2 Years – Government Bond
Offering Amount	€20,000,000
Instrument Code	KV1213011309
Auction Date	23.10.2018
Settlement Date	24.10.2018
Maturity Date	24.10.2020
Pricing Mechanism	Multiple Price

Note: The Government of the Republic of Kosovo reserves the right to re-purchase this Issue through operations defined in the Regulation for Primary and Secondary Market of Government Securities.

Objava Aukcije Hartija od Vrednosti KV018-18

Rok i Tip	2 Godina – Drzavna Obveznic
Ponudeni Iznos	€20,000,000
Instrument kod	KV1213011309
Datum Aukcije	23.10.2018
Datum Poravnaja	24.10.2018
Datum Dospjeća	24.10.2020
Mehanizam Cene	Visestruka Cena

Napomena: Vlada Republike Kosova ima pravo da ponovo otkupi obveznic preko operacija definisanih u Uredbi o Primarnom i Sekundarnom Tržištu Drzavnih Hartija od Vrednosti.

BQK/CBK Tel.: (038) 222-055 ext. 246

Drejtor i Përgjithshëm i Thesarit

Ahmet Ismaili



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Infrastrukturës
Ministarstvo Infrastrukture
Ministry of Infrastructure

ANULIM I KONKURISIT

Anulohet konkursi për pozitën, **Asistent/e Administrativ/e në Njsh-Mitrovicë**, me numër të referencës RN00003719 i shpallur më 14.09.2018 deri 28.09.2018, për arsye se kandidatët të cilët kanë aplikuar në këtë pozitë, nuk i kanë plotësuar kriteret sipas konkursit.

Nga aplikuesit për këte pozite kërkohet mirëkuptim.

ANULIRANJE KONKURSA

Anulira se konkurs za položaj **Administrativni Asistent u Jvp-Mitrovica**, br. reference RN00003719 objavljen 14.09.2018.god do 28.09.2018, iz razloga kandidati koji su se prijavili za ovu poziciju, nisu ispunili uvjete konkursa.

Molimo prijavljene kandidate za razumijevanje!



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit / Kabinet Precednika / Office of the Mayor

Në bazë të dispozitave ligjore të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", nr.28/15, qershor 2008), nenit 5 paragrafi 1 të Ligjit nr.03/L-205 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", nr.91/10, dhjetor 2010) dhe nenit 15 të Statutit të Komunës së Skenderajit, Kryetari i Komunës së Skenderajit, merr këtë:

VENDIM

- I. AUTORIZOHET Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë, për kryerjen e punëve përgaditore, Incizimin e parcelës dhe verifikimin e sipërfaqës së pronës së paluajtshme në pronësi të Ferat (Rama) Sinani nga Ternaci Komuna e Skenderajit, në ngastrën nr.17-0, me kulturë Mal në vendin e qujtur Brus-Leska, në sipërfaqe të përgjithshme 8.05.34 ha, ZK në Ternave. Ndarjen e kesaj parcele në sipërfaqe prej 0.34.64 ha për realizimin e interesit të përgjithshëm për ndërtimin e rezervuarit të ujit për Komunën e Skenderajit.
- II. Autorizimi ipët për qëllimin e cekur më lart dhe për qëllime të tjera nuk mund të përdoret.
- III. Vendimi hynë në fuqi nga dita e shpalljes në Gazeten Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe një prej gazetave me tirazh me të madh në Kosovë.

Nr. 02-464/01-0058649/11

Skenderaj me dt. 17.10.2018

Vendimi i dergohet

DGJKP
Arhiv



>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Vlora Gashi shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHMM "Luciano Motroni" Prizren
- Shqipe Muqaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl - VIII SHFMU "Pjeter Mazreku" Lubizhd e Hasit
- Resid Bahsani shpall te pavlefshme dëftesat diplomën certifikatat SHMLT "11 Marsi" Prizren
- Dzemail Bajsin shpall te pavlefshme dëftesat diplomën certifikatat SHMLT "11 Marsi" Prizren
- Gezim Sertollaj shpall te pavlefshme dëftesat diplomën certifikatat SHMGJ "Gjon Buzuku" Prizren
- Lumni Hameli shpall te pavlefshme dëftesat e kl - VIII SHFMU "Pjeter Mazreku" Mazrek
- Bashkëpronarja Vesna Grujic shet pjesën e vetë ideale në parcelën kadastrale P-70202018-00001K-0 Zona Kadastrale Gojbule Komuna e Zveçanit. Ftohen bashkëpronaret që nëse janë të interesuar për blerje të kësaj prone të lajmërohen te i autorizuar i saj Savic Dimitrije nga Zveçani.
- Urgjentisht kërkohet banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhomë gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155
- Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.
- Urgjentisht kërkohet banesë me qira ne Prishtine, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhomë gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155
- Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.
- Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.
- Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbraha konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958
- Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësorje me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.
- Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

Lëshoj shtëpinë me qira, e cila gjendet në lagjen e "Universiteti" përball rrugës B dhe përball marketit Viva Fresh Store. Shtëpia është 100 metra katror dhe e mobiluar. Është e përshtatshme për zyre dhe banim. Numri kontaktues 049-574-169.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

